




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org



Raport i Punës së Ekzekutivit për periudhën janar – dhjetor 2016

Prill/2017

Fjala hyrëse

Komuna si njësi themelore e pushtetit lokal funksionon në bazë të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, si dhe ligjeve të tjera me të cilat janë përcaktuar kompetencat dhe fushëveprimi i saj. Qeverisja e mirë në komunën tonë ka qenë dhe do të jetë ndër objektivat tona kryesore dhe në përputhje me planin tonë strategjik, me të cilin plan synojmë të kontribuojmë në përmirësimin e shërbimeve komunale. Modalitetet e qeverisjes sonë gjatë kësaj kohe për të cilën po raportojmë janë karakterizuar me ngritjen e performancës në të gjithë sektorët, cilësinë e shërbimeve, si dhe transparencën komunale. Raporti pasqyron përmbledhjen e punës për periudhën janar –dhjetor 2016 të zyrës së kryetarit të komunës, zyrave të tjera që janë në kuadër të zyrës së kryetarit dhe drejtorive komunale, ku janë prezantuar aktivitetet që pasqyrojnë dhe reflektojnë angazhimin dhe rezultatet e shënuara në këtë periudhë. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2016 janë realizuar objektivat programore dhe politike të planifikuara përmes projeksioneve buxhetore për realizimin e projekteve nga sektorë të ndryshëm me interes për qytetarët e komunës sonë. Prioritetet e politikave publike ka qenë ngritja e cilësisë së shërbimeve komunale dhe realizimi i kërkesave të qytetarëve për projekte në infrastrukturë dhe fusha të tjera. Janë rritur parametrat e vlerësimit të punës dhe është rritur cilësia e punimeve në infrastrukturë si: rrugë, kanalizim, ujësjellës, mbrojtje të mjedisit, e të tjera.

Ky Raport gjithëpërfshirës, ka për qëllim që të nënvizojë progresin e arritur në realizimin e prioritetëve të Komunës, me theks të veçantë progresin e arritur përgjatë vitit 2016. Në këtë aspekt, ky Raport ka si pikë reference Programin e Qeverisë Komunale. Po ashtu, Raporti Vjetor është një mjet i komunikimit të të arriturave të pushtetit lokal, përkushtimit, angazhimit dhe vendosmërisë së treguar në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve me qëllim të rritjes së mirëqenies së qytetarëve në përgjithësi duke ndërmarrë veprimet e nevojshme në kuadër të kompetencave të veta.

Jemi angazhuar fuqishëm që të arrijmë nivelin më të lartë të transparencës komunale dhe në vazhdimësi jemi kujdesur që praktikat më të avancuara demokratike, të aplikohen gjatë vendimmarrjes në qeverinë komunale. Kemi realizuar me shumë se 30 projekte në fusha të ndryshme vlera e të cilave është 3 milion e 7 mijë e 363 euro. Është bërë një punë e mirë edhe në realizimin e të hyrave komunale sidomos tatimit në pronë ndërsa kemi zvogëluar buxhetore në shumë fusha.

Pasqyrë e shkurtër mbi aktivitetet e drejtorive komunale

Drejtoria e Administratës - për vitit 2016 ka realizuar punët sipas Planit të punës së Drejtorisë, duke ofruar shërbime për qytetarë, nga të gjitha zyrat me të cilat administron, të specifikuar si me poshtë, janë kryer punët si në vijim: Sektori i gjendjes civile dhe regjistrimit, Zyra prokurimit, Shërbimi për punë të drejtat e fëmijëve dhe Sektori teknik-logjistika.

Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit - në kuadër të kësaj drejtoria vepron Sektori për buxhet dhe financa dhe ai për Tatimin në pronë. Janë përgatitur dhe lëshuar aktvendime të ngarkesave me taksa, ankesa sipas procedurave të parapara ligjore, aktvendime të lokaleve komunale që shfrytëzojnë hapësirën publike, vendime të përgjithshme administrativo-juridike e tjera.

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, gjatë vitit 2016, ka pasur në fokus riorganizimin dhe ristrukturimin e planifikuar të punës në QKMF, QMF dhe AMF, duke krijuar parametrat e funksionalitetit të nevojshëm dhe plotësimin e kapaciteteve të përgjithshme për mbrojtjen shëndetësore primare.

Drejtoria e Arsimit- aktivitetet kryesore kanë qenë të fokusuar në ngritjen e shkollës së cilësisë në procesin mësimor, zgjerimi hapësirave shkollore, sigurimi i mjeteve të nevojshme për punë në institucionet edukativo-arsimorë, trajnimi i personelit shkollor, programi i avancimit të mësimdhënësve, organizimi i me prindër dhe me komunitetin e saj.

Drejtoria e Urbanizimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit- gjithë fushë veprimtarin e vet e ushtron në bazë të dispozitave Ligjore, rregulloreve që janë në fuqi, dhe është ekzekutuese e drejtpërdrejt e Vendimeve të Asamblesë Komunale. Në kuadër të Drejtorisë për Urbanizëm, dhe Mbrojtje të Mjedisit veprojnë: Shërbimi i ndërtimit dhe Banimit, Zyra për Mjedis, Planifikimi Urban dhe Zyra për Projekte.

Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural- merret me zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimit rural, ku fillimisht janë bërë përgatitjet për mbjelljet pranverore, pastaj subvencionet për fermerë në fusha të ndryshme të bujqësisë, realizimin e projekteve të ndryshme për të ndihmuar bujqit, ujitjen e tokave bujqësore e tjera.

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe emergjente- në kuadër të kësaj drejtorie funksionojnë këto sektorë: Sektori i shërbimeve publike dhe shërbimi i zjarrifikësve. Disa nga aktivitetet e kësaj drejtorie kanë qënë: mirëmbajtja e rrugëve dimërore dhe verore, ndriçimi eficient i qytetit me drita te standardit me te lart (LED) dhe mirëmbajtja e tyre, dhënia e ndihmave me material ndërtimor për familjet ne kushte ekonomike te dobëta dhe kryesisht raste sociale e tjera.

Drejtoria e Inspektoratit- funksioni themelor i këtyre organeve në kuadër të kësaj Drejtorie për periudhën raportuese është manifestuar në mbikëqyjen kontrollin inspektues të zbatimit të ligjshmërisë nga lëmi i shërbimeve publike,ndërtimit,bujqësisë dhe ambientit, tregut, trafikut, sanitare dhe atij financiar-legalizimit të ushtrimit të aktivitetit biznesor të subjekteve ekonomike dhe joekonomike etj.

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi – ka kryer një sërë punësh dhe detyrash të ndryshme nga lëmia e vet e veprimtarisë duke plotësuar kështu nevojat e qytetarëve për dokumentacion të nevojshëm lidhur me pronat dhe duke lëshuar dokumente publike , po ashtu duke proceduar kërkesa për ndarje të pronave , regjistrim te hipotekave, parcelime, ekspertiza gjeodezike etj.

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit- në kuadër të kësaj drejtorie veprojnë, Sektori i kulturës, Arkivi historik, Zyra e trashëgimisë kulturore, Biblioteka e Qytetit, Zyra e sportit dhe rinisë. Pothuajse në të gjitha këta sektorë janë kryer punët me përgjegjësinë me të lartë duke u bazuar në infrastrukturën ligjore.

ZYRA E PROKURIMIT

Projektet 2016

nr	Projekti	Kostoja	Komuna	Donacion	Donatori	Plani	Vërejtje
1	NDERTIMI ME GURE I SHESHIT DHE RUGEVE NE QYTET	1.423.054.67	1.423.054.67	0		365 DITE	NE IMPLEMENTIM PROJEKT TREVJEQAR
2	NDERTIMI I OBJEKTIT TE SHKOLLES NE KPUZ-FAZA TRETE	108.051.31	38.051.31	70.000.00	MASHT		REALIZUAR
3	NDERTIMI I OBJEKTIT TE SHKOLLES NE JASHANICE -- FAZA E TRETE	151.052.63	74.052.63	77.000.00	MASHT		REALIZUAR
4	NDERTIMI I OBJEKTIT TE SHKOLLES PERQEVE -- FAZA E TRETE	132.751.62	79.751.62	53.000.00	MASHT		REALIZUAR
5	DISAJNIMI I PROJEKTEVE ZBATUESE PER UJESJELLES KANALIZIME , RRUGE DHE OBJEKTE	38.370.00	38.370.00	0		36 MUAJ	NE REALIZIM PROJEKT TREVJEQAR
6	FURNIZIM ME TRAFI PER PALESTRENE SPORTEVE	9.586.00	9.586.00	0			REALIZUAR
7	ASGJESIMI I QENEVE ENDACAK	15.000.00	15.000.00	0			REALIZUAR
	TOTALI I FAQES 1	1.877.866.13	1.677.866.13	200.000.00			PERFUNDUAR

nr	Projekti	Kostoja	Komuna	Donacion	Donatori	Plani	Vërejtje
8	MIREMBAJTJE DHE SERVISIM I KAMERAVE TE VEZHGIMIT NE QYTET	15.537.60	15.537.60	0		36 MUAJ	NE REALIZIM PROJET TREVJEQAR
9	NDERTIMI I DY KATEVE NE OBJEKTIN E STREHIMIT	107.776.64	40.776.64	67.000.00	MPMS		REALIZUAR
10	INTERVENIME EMERGJENTE ME RASTIN E VERSHIMEVE	9.950.00	9950.00	0			REALIZUAR
11	MBIKQYRJE E PUNIMEVE NE SHESH	6.262.65	0	0			
12	ASFALTIMI I RRUGEVE NE QYTET	49.512.52	39.150.52	10.362.00		365 DITE	NE IMPLEMENTIM PROJEKT TREVJEQAR REALIZUAR
13	ASFALTIMI I RRUGES NE DUGAJEVE TE KISHA	23.988.95	18.988.95	5.000.00	KOMUNI TETI		REALIZUAR
14	NDERTIMI I KANALIT PER UJTJE NE KRUSHEVE TE MADHE FAZA PARE DHE DYTE	41.728.98	20.913.25	0	KOMUNI TETI		REALIZUAR
15	BAZAMENTI I BUSTIT NE SHESHIN NDUE PERLLESHI	6.389.50	6.389.50	0			REALIZUAR
16	NDERTIMI I KANALIT PER UJTJE NE GREMNIK	42.206.88	42.206.88	0			REALIZUAR
17	ASFALTIMI I RRUGES NE KERNICE	116.618.72	22.368.72	94.250.00			
18	ASFALTIMI I RRUGES NE GJURGJEVIK TE MADHE	94.506.31	20.846.31	73.660.00	M.I, M.I		NE REALIZIM NE REALIZIM

TOTALI 2		514.738.75	264.466.75	250.272.00		
nr	Projekti	kostoja	komuna	donacion	donatori	PLANI
						vërejtje
19	KANALIZIMI NE POTERQE - FAZA E FUNDT	33.769.92	33.769.92	0		REALIZUAR
20	KANALIZIMI NE GREJNIK- FAZA E TRET	49.516.32	46.516.32	0		REALIZUAR
21	KANALIZIMI NE BUDISALC - FAZA DYTE					NE REALIZIM
22	ASFALTIMI I RRUGEVE SYLE PALUSHI , OSMAN KRASNIQI , MIC SOKOLI DHE KUVENDI I LEZHES NE QYTET	42.546.57	30.046.57	12.500.00	KOMUNI TETI	REALIZUAR
23	REHABILITIMI I PODEVE NE SHFMU KLINE	3.452.14	3.452.14	0		REALIZUAR
24	LYERJA E MUREVE NE SHFMU BUDISALC	3.770.60	3.770.60	0		REALIZUAR
25	HAPJA E PUSAVE NE SHKOLLAT UJMR	4.050.00	4.050.00	0		REALIZUAR
26	NDERTIM I INSTALIM I NGROHJES QENDRORE NE GJIMNAZ	39.666.00	39.666.00	0		REALIZUAR
27	NDERTIMI I URES RANOC	13.333.70	12.533.70	800.00		REALIZUAR
28	REHABILITIM I SHTARTIT LUMIT KLINA	34.700.00	3.100.00	31.600.00	KOMUNI TETI MMPH	NE REALIZIM
29	ASFALTIMI I RRUGES STUP ZAJM - FAZA PARE	139.647.16	39.647.16	100.000.00	MI.	REALIZUAR
TOTALI I FAQES 3		398.452.41	253.552.41	144.900.00		NE REALIZIM

nr	Projekti	kostoja	komuna	donacion	donatori	PLANI	vërejtje
30	ASFALTIMI I RRUGES KERNICE -FAZA DYTE	29.971.34	29.971.34	0			NE REALIZIM
31	ASFALTIMI I RRUGES GJURGJEVIK I MADHE -FAZA DYTE	31.308.25	31.308.25	0			NE REALIZIM
32	ASFALTIMI I RRUGES KLINAVC	155.026.47	64.781.47	90.245.00	USAID		PERFUNDUAR
	Totali I faqes 4	216.306.06	226.061.06	90.245.00			
	GJENDJA	3.007.363.28	2.321.946.88	685.417.00			
	FAQE 1 + 2+3+4						

Raportet e të gjitha drejtorive në mënyrë të specifikuar

DREJTORIA E ADMINISTRATËS

Drejtoria e Administratës për vitin 2016 ka realizuar punët sipas Planit të punës së Drejtorisë, duke ofruar shërbime për qytetarë nga të gjitha zyrat me të cilat administron, të specifikuara si më poshtë, janë kryer punët si në vijim:

Spektori i gjendjes civile dhe regjistrimit

Nga Spektori i Gjendjes Civile dhe Regjistrimit, në periudhën raportuese janë bërë 1427 regjistrime të ndryshme lindjes, martesave dhe vdekjes; janë lëshuar gjithsej 55.773, lloje të certifikatave dhe akte të tjera. Lëndët e ardhura nga gjykatat- 144 (shkurorëzimi i martesave, dëshmi vdekje, pranimit i atësisë, vërtetimit për regjistrim në LAL dhe ndërrim - korrigjim nga librat amëz).

Lëndët e punuara nga Shefi i gjendjes civile - 230 (regjistrim i mëvonshëm në LAL, korrigjim - ndërrim i emrit dhe mbiemrit, aktvendim për anulimin e regjistrimeve dhe procesverbale për dëgjimin e dëshmitarëve). Për vitin 2016 janë inkasuar taksa administrative prej 53,366.25 €.

Zyra e prokurimit

Puna e Zyrës së Prokurimit e themeluar në bazë të LPP dhe Organogramit të Komunës. Punën e vet e kryen bazuar te LPP 04/L-042 dhe rregullore ne fuqi mbi Prokurimin publik dhe Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike.

Zyra në afatin ligjor ka bërë planifikimin e PP, i cili është miratuar në Kuvendin e Komunës dhe është dorëzuar në APP.

Në vitin 2016 kemi iniciuar 92 procedura të prokurimit, nga të cilat janë nënshkruar 90 kontrata, vlera e tërësishme e kontratave të nënshkruara është 1.409.357.16 €.

- Dy kontrata që ende nuk janë nënshkruar, të cilat nuk kanë mundur të përfundojnë në vitin 2016:
1. Servisimi i nxeçjeve qendrore;
2. Furnizimi me GPS.

Vlen të ceket se Zyra e Prokurimit është shumë transparente dhe të gjitha procedurat i ka bërë publike në ueb-faqen e Krpp. Gjatë kësaj kohe është bërë edhe auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 (para auditues) nga Auditori Gjeneral, po në këtë vit ka pasur edhe auditim nga Auditori i Brendshëm, që bazuar

në raportin nga auditori i procesit të prokurimit janë gjetur dhe dhënë disa komente. Këto komente të gjitha kanë të bëjnë me vonesën e projekteve në implementimin dhe jo arsyshmërinë nga komisionet për përcjelljen e punëve pse ato kanë vonesë nga plani për implementim.

Nga viti 2017 ka hyrë në fuqi LPP 05/L-068 i ndryshuar dhe amendamentuar me Ligjin 05/L-092, ku ka ndryshime dhe tani duhet aplikuar E-prokurimi.

Shërbimi për punë të kuvendit

Shërbimi për Punë të Kuvendit për vitin 2016 ka përgatitur materialin për 11 seanca të rregullta, 4 seanca solemne, debate me publikum lidhur me shqyrtimin e projekt-rregulloreve komunale, 4 seanca, janë hartuar gjithsej 49 vendime të KK Klinës, ka miratuar 4 rregullore komunale, të gjitha vendimet dhe rregulloret e Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 11 seanca, ka shqyrtuar 28 kërkesa dhe ua ka dërguar për rekomandim Kuvendit të Komunës, ka shqyrtuar propozim-vendime, draft - rregullore dhe draft-planin komunal.

Komiteti për komunitete ka mbajtur 11 seanca dhe ka shqyrtuar një kërkesë që e ka rekomanduar për Drejtorinë e Arsimit.

Komiteti për shërbime publike ka mbajtur 6 seanca.

Nga Shërbimi i lekturimit, lektori ka kryer punët rreth lektorimit të të gjitha akteve të lëshuara dhe aprovuara nga Ekzekutivi dhe Legjislativi, si dhe janë mbajtur procesverbalet e mbledhjeve. Po ashtu, është bërë përkthimi i akteve të Komunës.

Zyra pritëse-arkiva

Nga kjo Zyrë janë regjistruar dhe proceduar për vendosje në Zyrën e Kryetarit dhe nëpër drejtori, 5245 lëndë. Janë regjistruar edhe vërtetuar, përshkrime dhe dorëshkrime. Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar edhe 256 kërkesa të palëve.

Janë pranuar, regjistruar dhe përcjellë 239 lëndë nga posta për të gjitha shërbimet. Janë punuar 2215 lëndë nga kompetenca e Zyrës sipas ligjit në fuqi, si dhe 40 shkresa janë regjistruar për përcjellje në terren tek palët dhe zyrtarët.

Taksa e inkasuar është në vlerë prej 8.115.25 €.

Zyra Informimit

Zyra për Informim në kuadër të Komunës së Klinës, i mbulon të gjitha aktivitetet që zhvillohen në Komunë. Kjo Zyrë udhëhiqet nga zyrtarja për informim, Samije Gjergjaj. Në faqen e Komunës prezantohen aktivitetet e Kuvendit të Komunës, Kryetarit, drejtorive dhe aktivitetet të tjera që zhvillohen në kuadër të Komunës së Klinës dhe më gjerë. Të gjitha këto aktivitete prezantohen në faqen zyrtare të Komunës-<http://kk.rks-gov.net/kline/>, në portalin e internetit, si dhe në mediet dhe për të gjitha aktivitetet i ofron për të. Njëherë, kjo Zyrë i ka siguruar të gjitha informacionet të shtypit ditor. Ka marrëdhënie të mira me <http://kk.rks-gov.net/kline/>, dhe iu shpërndan të gjitha medieve. Përcjellja e të gjitha aktiviteteve që zhvillohen brenda dhe jashtë Komunës është përgjegjësi me peshë e Zyrës për Informim.

Zyra për Informim që nga dhjetori i vitit 2011 merret me kërkesat e qytetarëve në Qasjen e Dokumenteve Zyrtare dhe bën raport në çdo tre muaj në Qeverinë e Kosovës, si dhe raportin vjetor.

Zyra për Informim publik dhe marrëdhënie me publikun tani në vitin 2016, ka filluar të bashkëpunojë edhe me gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës dhe i është dhënë përgjegjësia për publikimin e të gjitha rregulloreve komunale të Komunës së Klinës.

Njësia për të drejtat e njeriut

Në kuadër të Njesisë, janë zhvilluar aktivitete të ndryshme që kanë të bëjnë me promovimin e të drejtave e njeriut në përgjithësi (të drejtat e grave, të drejtat e fëmijëve, të personave me aftësi të kufizuara, mundësi të barabarta, të drejtave të komuniteteve etj). Janë përcjellë dhe organizuar trajnime për të Drejtat e Njeriut, punëtori si dhe bashkëpunime OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare, zyrtarët për çështje gjinore të komunave tjera, si dhe takime të tjera për arritje të Barazisë Gjinore dhe respektimit të të Drejtave të Njeriut. Janë plotësuar raporte për Qeverinë e Kosovës rreth respektimit të drejtave të njeriut në Komunën e Klinës. T'i koordinojmë dhe t'i mbikëqyrim politikikat në Komunë në fushën e të drejtave të njeriut, politikat mbi barazinë gjinore, përdorimi i gjuhëve të barabarta, zbatimi i politikave të personave me aftësi të kufizuara, të drejtat e fëmijëve kundër diskriminimit dhe antitrafikim.

Zyra komunale për integritete evropiane

Është punuar dhe koordinuar në procesin e implementimit të Planit të Veprimt për MSA-në, ku për vitin 2016 ka zhvilluar 29 aktivitete në Komunë, duke kryer punët në koordinim të ngushtë me udhëzimet e marra nga Pushteti qendror. Janë organizuar trajnime në bashkëpunim me organizata vendore dhe ndërkombëtare, po ashtu edhe ka marrë pjesë në trajnime të ndryshme.

Në mars 2016 është miratuar nga Qeveria Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit (PKZMSA).

Strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar.

MSA vendos Kornizën e Marrëdhënieve të Kosovës me shtetet anëtare dhe institucionet e BE-së për jetësimin e Procesit të Stabilizim-Asociimit (PSA) deri në anëtarësimin e plotë në BE. Sa i përket fushëveprimit, përveç çështjeve politike e detyrimeve juridike (përfshirë ato që prekin rendin e brendshëm juridik), MSA mbulon të gjitha sferat e qeverisjes. Ajo përmban dhjetë tituj-kapituj kryesorë.

Zyra për teknologji informative

Gjatë vitit 2016, Zyra e teknologjisë informative ka kryer këto shërbime si vijon: Implementimin e aplikacionit të E-qeverisjes në Komunën Klinë. Gjatë vitit 2016 në Administratën komunale, Zyra e teknologjisë informative ka intervenuar në 1864 probleme me kompjuterë, që u janë shfaqur përdoruesve të sistemit të Komunës së Klinës, ndërsa edhe 320 intervenime në pajisje tjera periferike, si printerë, fotokopje, skanerë etj. Me ndihmën e Zyrës së teknologjisë informative janë gjeneruar vendimet për ngarkesa të bizneseve me taksa komunale nga Drejtoria e Financave. Kjo Zyra e ka mbështetur të gjithë stafin e Komunës së Klinës, po ashtu edhe në disa shkolla fillore dhe QKMF dhe QPS në problemet që u janë shfaqur gjatë përdorimit të pajisjeve të teknologjisë informative, edhe të gjitha Zyrat e gjendjes civile në terren në Komunën e Klinës, ku në disa raste edhe ka bërë intervenime në distancë, ndërsa në raste të tjera intervenimi është bërë edhe lokalist dhe koordinimin për intervenimet të problemeve me lidhje VPN. Po ashtu, ka mirëmbajtur serverët, databazat dhe rrjetin, që mundësojnë shërbimin elektronik në Komunën e Klinës. Për vitin 2016 janë marrë të gjitha masat e sigurisë, të cilat rekomandohen nga Microsofti dhe nga Agjencioni i Shoqërisë së Informacioneve, dhe janë bërë Backup të dhënave për arsye të sigurisë konform udhëzimeve administrative.

Zyra e pranimin të mallit

Nga ky Sektor është kryer puna e pranimin të mallit, të hyrave edhe të daljeve të materialeve shpenzuese, si të kompjuterëve, printerëve, fotokopjeve e materiale të tjetër shpenzues, gjithashtu janë kryer edhe raporte të pagesave në fri-balanc, ku numri i tyre është 1373.

Sектори teknik-логjistика

Nga ky Sektor është kryer: ruajtja e objektit të Komunës, organizimi i punës me palë, mirëmbajtja e pastërtisë, mirëmbajtja e ngruhjes, përcjellja e shpenzimeve të derivateve, mirëmbajtja e veturave zyrtare, përcjellja e shkrësive për organe dhe palët dhe punë të tjera sipas nevojës.

DREJTORIA PËR FINANCA, EKONOMI DHE ZHVILLIM

Gjatë vitit 2016 Janë kryer punë në harmoni me Statutin e Komunës, Ligjin Mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, Ligjin Mbi financat Lokale, Udhëzimeve administrative të nxjerë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi që dalin nga to dhe bazuar në Planin e punës së aprovuar nga kuvendi komunal për vitin 2016 siç vijon:

Janë përgatitur dhe lëshuar 970 aktvendime të Taksave komunale për vitin 2016 siç vijon:

Janë vendosur ju kanë dorëzuar të gjithë obliguesve të Taksave komunale për ushtrim të veprimtarisë për subjektet afariste që operojnë në Komunën tone në vitin 2016 Janë vendosur dhe lëshuar 107 aktvendime të Ankesave të ushtruara nga subjektet afariste në afat të paraparë ligjor.

Janë lëshuar 30 aktvendime në përputhshmëri me procedurat e Ligjit Mbi tatimin në Pronën e paluajtshme në Kosovë.

Janë lëshuar 21 Vendime të ndryshme juridike lidhur me veprimtarit dhe natyrën e punëve të Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.

Është bërë çregjistrimi-shlyerja e 107 obliguesve tatimor nga regjistri I obligimeve në kontabilitet duke u bazuar në vendimet e ankesave të vendosura në vitin 2016.

Vlen të ceket se në sektorin e taksave komunale problem kyç është mos regjistrimi I subjekteve afariste në mënyre legale dhe mos shlyerja e bizneseve sipas procedurave të parapara ligjore (subjektet që janë shuar dhe nuk funksionojnë).

Spektori për buxhet dhe financa

Është bërë barja e mjeteve të pa shpenzuara nga viti 2015,

Është përgatitur rjedha e parasë së gatshme për të gjitha programet,

Janë përgatitur pasqyrat financiare 2015,

Është bërë rishikimi I buxhetit,

Janë bërë raportet tremujore, gjashtëmujore nëntëmujore dhe raporti vjetor në Asamble dhe për nivelin qendror,

Është bërë planifikimi I buxhetit për vitin 2017,

Janë certifikuar të gjitha shkresat për Ministrinë e Financave ne lidhje me transferet Brenda programeve dhe kërkesave të ndryshme për realizim të projekteve,

Janë kryer të gjitha pagesat për mallra dhe shërbime dhe për punë,

Janë bërë të gjitha zotimet për shpenzimet e bëra gjatë vitit,

Nxjerja e raporteve për zotime,

Janë zotuar 1495 zotime vetëm gjatë vitit 2016.

Është bërë evidencimi i tyre sipas programeve dhe kodeve ekonomike në excel,

Barazimi I rregullt i shpenzimeve në baza tre mujore në MF,

Janë lëshuar 915 vërtetime për obliguesit e taksave që i kanë përmbushur obligimet e taksave,

Është bërë regjistrimi dhe raportimi i të gjitha te hyrave në FREBALNC dhe raportuar në MF,

Janë lëshuar 148 certifikata të gjendjes ekonomike për qytetaret e interesuar sipas kërkesave,

Janë përgatitur dhe përcjelle të gjitha pagesat e PTKESH-it
Janë regjistruar 105 biznese te reja,
Janë çregjistruar 32 biznese etj.

Sektori i tatimit në pronë

Janë lëshuar 11. 800 fatura tatimore,
Janë lëshuar 8750 certifikata tatimore,
Janë bërë 172 regjistrime te reja të objekteve qe janë tatimuar për here të pare,
Janë kryer të gjitha punët rreth ligjit mbi fajten e borxheve,
Janë kryer dhe shumë punë tjera, por me hollësisht shihen edhe ne tabelat e raportit financiar vjetor.

Raport financiar për buxhetin , të hyrat dhe shpenzimet për periudhën janar – dhjetor 2016

Për të analizuar realizimin e buxhetit në periudhën janar – dhjetor 2016 do të japim një pasqyrë të buxhetit , të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore , do të analizojmë disa trendë të këtyre kategorive buxhetore si dhe do të bëjmë disa krahasime me parametrat buxhetor për këtë periudhë dhe disa krahasime me periudhën e njëjtë të vitit paraprak .


Buxheti në SIMFK i vitit 2016 sipas burimit

Burimi	Buxheti sipas SIMFK 2016	% në total	Buxheti sipas SIMFK 2015	Ndryshimi nga 2015 në %
Granti qeveritar	7,515,661.16	84.44	7,631,770.67	-1.5
Të hyrat vetanake 2016	1,028,000.00	11.55	857,767.00	19.8
Të hyrat e bartura	206,498.01	2.32	366,511.45	-43.7
Participimi i qytetarëve	36,484.31	0.41	55,831.81	-34.7
Save the Children	63,488.21	0.71	4,150.08	1429.8
USAID	44,795.70	0.50		
IOM	6,000.00	0.07		
Gjithsej :	8,900,927.39	100.00	8,916,031.01	-0.17

Tabela 1. Buxheti në SIMFK për janar-dhjetor 2016 sipas burimit

Siç shihet nga tabela më lartë buxheti sipas SIMFK për janar- dhjetor 2016 është më i vogël për rreth 0.17 % se buxheti për periudhën e njëjtë të vitit 2015

Buxheti sipas burimit



Grafiku 1. Buxheti në SIMFK për janar- dhjetor sipas burimit

Krahasuar me vitin paraprak , në vitin 2016 shpenzimet në total në vlerë 8,376,332.94 € janë më të vogla për rreth 2.7% se shpenzimet e vitit 2015 që ishin 8,611,908.24% .

Shpenzimet e buxhetit në periudhën janar – dhjetor 2016 sipas kategorive ekonomike


Përshkrimi	Buxheti SIMFK 2016	Shpenz. janar-dhjetor 2016	% në total	Shpenz. janar-dhjetor 2015	Krhasimi 2016 me 2015 në %
Paga dhe mëditje	5,688,775.73	5,674,867.65	67.75	5,570,740.44	1.87%
Mallra dhe shërbime	630,709.96	606,417.19	7.24	620,164.20	-2.22%
Shërbime komunale	161,287.85	161,095.48	1.92	170,353.02	-5.43%
Subvencione dhe transf.	74,123.81	61,655.63	0.74	79,501.55	-22.45%
Kapitale	2,346,030.04	1,872,296.99	22.35	2,171,149.03	-13.76%
Gjithsej :	8,900,927.39	8,376,332.94	100.00%	8,611,908.24	-2.7%

Tabela 3. Shpenzimet e buxhetit për periudhën janar – dhjetor 2016 sipas kategorive ekonomike

Nga buxheti i shpenzuar në periudhën janar – dhjetor 2016 në vlerë 8,376,332.94 € për paga dhe mëditje janë shpenzuar 5,674,867.65 € (74.75 % e shpenzimeve), për mallra dhe shërbime janë shpenzuar 606,417.19 € (7.24% e shpenzimeve), për shërbime komunale 161,095.48 € (1.92 % e shpenzimeve), për subvencione 61,655.63, € (0.74 % e shpenzimeve) dhe për kapitale 1,872,296.99 € (22.35 % e shpenzimeve).

Shpenzimet në periudhën janar-dhjetor 2016 në vlerë 8,376,332.94 € krahasuar me shpenzimet për periudhën e njëjtë të vitit 2015 në vlerë 8,611,908.24 € janë zvogëluar rreth 2.74%. Shpenzimet për paga dhe mëditje krahasuar me vitin paraprak janë rritur 1.87%, shpenzimet për mallra dhe shërbime janë zvogëluar për 2.22%, shpenzimet për shërbime komunale janë zvogëluar për 5.43%, shpenzimet për subvencione janë zvogëluar për 22.45% dhe shpenzimet për kapitale janë zvogëluar për 13.76%.

Shpenzimet për janar-dhjetor 2016 sipas kategorive



Grafiku 2. Shpenzimet buxhetore në periudhën janar – dhjetor 2016 sipas kategorive

Të hyrat e realizuara në periudhën janar-dhjetor 2016 dhe krahasimi me periudhën e njëjtë të vitit paraprak

Nr.	KODI EKONOMIK	LLOJET E TRANSAKSIONEVE	Janar-dhjetor 2015	% në total	Janar-dhjetor 2016	% në total	Krahasimi 2015/2016	Ndryshimi në €
1	40110	TATIMI NE PRONE	265,541.51	31.33	297,767.80	34.15		32,226.29
2	50001	TAKSAT PER RRUGE	58,481.00	6.90	62,770.00	7.20		4,289.00
3	50009	URBANIZEM	57,758.78	6.81	57,066.53	6.54		-692.25
4	50011	TRANSAKCIONI	1,336.00	0.16	-	0.00		-1,336.00
5	50013	ÇERTIFIKATAT E LINDJES	21,452.00	2.53	23,094.50	2.65		1,642.50
6	50014	ÇERTIFIKATAT KURORZIMIT						
7	50015	ÇERTIFIKATAT E VDEKJES	6,474.00	0.76	8,088.00	0.93		1,614.00
8	50016	ÇERTIFIKATAT TJERA	552.00	0.07	922.00	0.11		370.00
9	50017	TE HYRAT TJERA	15,668.00	1.85	21,544.00	2.47		5,876.00
10	50019	TAKSAT ADMINISTRATIVE	5,050.05	0.60	6,281.00	0.72		1,230.95
11	50103	LARGIMI DHE DEPONIM I AUTOMJETE.	8,115.25	0.96	6,728.95	0.77		-1,386.30
12	50104	INSPEK.-DEN. MANDATORE	1,688.75	0.20	922.50	0.11		-766.25
13	50205	KOMISIONI INSPEKTUES	1,390.00	0.16	1,470.00	0.17		80.00
14	50217	LICENCIMI	2,294.00	0.27	4,979.00	0.57		2,685.00
15	50403	SHITJA E PASURIS	61,135.00	7.21	65,416.00	7.50		4,281.00
16	50405	SHFRY I PRONES PUBLIKE	4,788.34	0.56	9,701.01	1.11		4,912.67
17	50406	QER.PER TREG TE HAPUR	2,582.00	0.30	4,579.00	0.53		1,997.00
18	50407	QER.E LOKALEVE(OBJ.AFAR)	1,440.00	0.17	1,010.00	0.12		-430.00
19	50408	QER.E BANESAVE (OBJ.SOCL.)	7,246.00	0.85	6,187.00	0.71		-1,059.00
20	50409	PARTICIPIM-KULTURA-ARSIMI	7,010.87	0.83	4,782.93	0.55		-2,227.94
21	50409	PARTICIPIM-QERDHJA	19,904.00	2.35	12,167.00	1.40		-7,737.00
			9,487.50	1.12	13,649.00	1.57		4,161.50

22	56000	DONACION -arsimi	4,150.08	0.49	9,819.77	1.13	5,669.69
23	50409	PARTICIPIM-SHENDETESIA	23,298.30	2.75	24,843.60	2.85	1,545.30
24	50413	PARTICIPIMET-QYTETARET	52,809.50	6.23	21,100.00	2.42	-31,709.50
25	50504	GJEODEZI&KADASTER	60,921.05	7.19	64,954.00	7.45	4,032.95
26		GJOBAT NGA TRAFIKU	39,935.50	4.71	34,206.50	3.92	-5,729.00
27		GJOBAT NGA GJKATAT	107,090.00	12.63	107,970.00	12.38	880.00

SHPENZIMET BUXHETORE PËR PERIUDHEN JANAR - DHJETOR 2016 DHE NDRYSHIMI ME VITIN 2015

Nr.rend.	Kodi ekonomik	Përshkrimi	Shpenzimet 2015	Shpenzimet 2016	Ndryshimi
1	11110	PAGAT NETO PERMES LISTAVE	4,754,669.26	4,835,303.03	80,633.77
2	11115	PAGESA PER SINDIKAT	24,707.09	25,030.76	323.67
3	11400	PUNT. ME KONTRATË	3,599.74	8,578.41	4,978.67
4	11500	TATIMI NE TARDHURA PERSONALE	257,346.03	266,068.97	8,722.94
5	11600	KONTRIBUTI PENSIONAL I PUNETORJ	265,209.16	269,970.69	4,761.53
6	11700	KONTRIBUTI PENSIONAL I PUNEDHENSI	265,209.16	269,915.79	4,706.63
TOTALI:	11	RROGAT DHE PAGAT	5,570,740.44	5,674,867.65	104,127.21
7	13130	SHPEN.UDHTIMIT BRENDA SHPENZ.	26,342.15	11,884.42	(14,457.73)
8	13133	UDHT.ZYRT.BRENDA VENDIT		11.80	11.80

9	13140	SHPEN.UDHTIMIT VENDIT	JASHT		125.4	125.40
10	13141	SHPEN.UDHTIMIT VENDIT	JASHT	3,537.80	3,969.80	432.00
11	13142	AKOMODIMI- UDH.ZYRT.JASHT VENDIT		36.00		(36.00)
12	13143	SHPENZ.TJERA- UDH.ZYRT.JASHT VENDI		3,476.92		(3,476.92)
13	13310	SHPENZ. PËR INTERNET		2,139.34	2,658.44	519.10
14	13320	SHPENZ.E TELEFONIT- MOBIL		24,605.86	21,813.01	(2,792.85)
15	13330	SHPENZIMET POSTARE		95.70	207.70	112.00
16	13340	SHP.PER KABLL.OPTIK	PERD. E	233.50		(233.50)
17	13410	SHERBIMET E ARSIMIT DHE TRAJNIMIT		-	193.60	193.60
18	13430	SHERBIME TE NDRYSHME SHENDETESORE		10.00		(10.00)
19	13450	SHERBIME SHTYPJE MARKETING	JO	30.00		(30.00)
20	13460	SHERB.KONTRAKTUESE TJERA		87,014.32	101,429.84	14,415.52
21	13470	SHERBIME TEKNIKE		1,374.00	241.00	(1,133.00)
22	13501	MOBILJE ME PAK SE 1000 EURO		2,154.23	8,701.70	6,547.47
23	13502	TELEFONA MA PAK SE 1000 Euro		1,260.00		(1,260.00)
24	13503	KOMPJUTER MË PAK SE 1000.00 E		2,963.00	16,841.64	13,878.64
25	13505	MAKINA FOTOKOPJUESE		1,319.00	2,242.00	923.00
26	13506	PAISJE SPECIFIKE MJEKSORE				

27	13509	PAISJE TJERA<1000 EURO	19,922.75	2,077.00	2,077.00
28	13610	FURNIZIME PERZYRE	51,896.89	33,948.42	14,025.67
29	13620	FURNIZIM USHQIM&PIJE(JO DREKA)	17,012.88	53,339.69	1,442.80
30	13630	FURNIZIME MJEKSORE	12,036.89	15,655.49	(1,357.39)
31	13640	FURNIZIM PASTRIMI	3,904.85	17,247.63	5,210.74
32	13650	FURNIZIM ME VESHMBATHJE	9,541.00	7,347.78	3,442.93
33	13710	VAJ	75.60	4,260.40	(5,280.60)
34	13720	NAFT PER NGROHJE QENDRORE	18,134.63		(75.60)
35	13750	QYMYR	10,766.84	24,394.18	6,259.55
36	13760	DRU	85,925.15	7,106.52	(3,660.32)
37	13770	DERIVATE PER GJENERATOR	899.31	97,105.11	11,179.96
38	13780	KARBURANTE PER VETURA	89,953.64	472.30	(427.01)
39	13810	AVANS PER PARA TE IMET(P.CASH)		48,276.80	(41,676.84)
40	13820	AVANS PER UDHTIME ZYRTARE			-
41	13950	REGJ.SIGURIMI AUTOMJETEVE I	4,833.22		-
42	13951	REGJ.SIGURIMI AUTOMJETEVE I	8,838.58	3,015.00	(1,818.22)
43	13952	TAKSA KOMUNALE REGJ.TE AUTOM. E	50.00	6,015.28	(2,823.30)
					(50.00)

44	13953	SIGURIMI I NDERTYESAVE TJERA	-	-	-	-	-
45	14010	MIRM.RIPARIMI AUTOMJETEVE	I	21,562.49	37,739.36	-	16,176.87
46	14020	MIRMBAJTJA E NDERTESAVE		9,165.06	4,837.74		(4,327.32)
47	14023	MIRMBAJTJA E SHKOLLAVE		60,540.99	39,211.44		(21,329.55)
48	14024	MIRMBAJTJA E OBJEKTEVE SHENDET.		-	-	-	-
49	14040	MIRMB. TEKNO. INFORMATIVE		1,472.10	1,017.53		(454.57)
50	14050	MIRMB. PAISJEVE DHE MOBILEVE		2,554.38	4,842.58		2,288.20
51	14060	MIRËMBAJTJA RUTINORE		-	-	-	-
52	14110	QIRAJA PER NDERTESA		2,000.00	5,000.00		3,000.00
53	14210	REKLAMAT DHE KONKURSET		4,068.00	7,490.00		3,422.00
54	14220	BOTIMET E PUBLIKIMEVE		50.00	-		(50.00)
55	14230	SHPENZ.PER INFORMIM PUBLIK		2,076.00	2,605.00		529.00
56	14310	DREKAT ZYRTARE		17,466.57	9,539.59		(7,926.98)
57	14410	SHPENZIMET- VENDIMET E GJYKATAVE		4,834.56	3,552.00		(1,282.56)
58	14420	PAGESA NENI 39.2 LMFPF		3,990.00	-		(3,990.00)
TOTALI: 13		MALLRA DHE SHERBIME		620,164.20	606,417.19		(13,747.01)
59	13210	RRYMA		97,987.37	94,864.76		(3,122.61)
60	13220	UJI			26,723.69		

61	13230	MBETURINAT	22,983.55		3,740.14
62	13250	SHPENZIMET TELEFONIKE	42,106.58	33,849.02	(8,257.56)
TOTALI: 14		SHPENZIMET KOMUNALE	170,353.02	161,095.48	(9,257.54)
63	21110	SUB.PER ENTITETET PUBLIKE	57,570.45	27,000.00	(30,570.45)
64	21200	SUB.PER ENTITETET JOPUBLIKE	18,825.00	34,655.63	15,830.63
65	22300	PAGESA -VENDIME GJYQESORE	3,106.10		
TOTALI: 20		SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	79,501.55	61,655.63	(17,845.92)
66	31110	NDERTESAT E BANIMIT	50,000.00	215,119.70	165,119.70
67	31121	OBJEKTET ARSIMORE	495,886.14	197,279.49	(298,606.65)
68	31123	OBJEKTET KULTURORE	5,866.00		(5,866.00)
69	31124	OBJEKTET SPORTIVE	15,426.30	8,604.62	(6,821.68)
70	31230	NDERTIMI I RRUGEVE LOKALE	544,992.15	863,877.77	318,885.62
71	31240	TROTUARET	2,880.20		(2,880.20)
72	31250	KANALIZIMI	136,671.39	161,791.46	25,120.07
73	31260	UJESJELLES	56,756.10	77,402.14	20,646.04
74	31270	MIREMBAJTJA INVESTIVE	74,280.70	74,716.07	435.37
75	31510	FURN. ME RRYME,GJENERIM E TRANSMIS.	39,231.68	25,870.53	(13,361.15)

76	31620	MOBILJE		25,287.63	1,588.00	(23,699.63)
77	31640	KOMPJUTER		6,399.50	4,736.52	(1,662.98)
78	31650	MAKINA FOTOKOPJUESE		5,250.00	2,478.00	(2,772.00)
79	31690	PAJISJE TJERA		29,137.36	1,214.30	(27,923.06)
80	31701	KAMION		47,185.00	1,580.00	(45,605.00)
81	31900	KAPITAL TJETER		284,977.29		(284,977.29)
82	32000	INVESTIMET NE VJIM		180,437.05	130,439.69	(49,997.36)
83	33100	TRANS.KAP.-ENTITETET PUBLIKE		31,814.83		(31,814.83)
84	33200	TRANS.KAP.-ENTITETET PUBLIKE	JO	92,145.11	5,099.94	(87,045.17)
85	34000	PAGESA - VENDIME GYQESORE		36,364.60	91,298.76	54,934.16
86	34100	PAGESA - NENI 39.2 LMFPF		1,986.00		(1,986.00)
87	35010	QENI-ASIS.NE RUAJTJE TE SIG.		8,174.00	9,200.00	1,026.00
TOTALI: 30		PASURIT JO FINANCIARE		2,171,149.03	1,872,296.99	(298,852.04)
TOTALI I PERGJITHSHEM:11,13,14,20,30						

DREJTORIA PËR SHËNDETSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, gjatë vitit 2016, ka pasur në fokus riorganizimin dhe ristrukturimin e planifikuar të punës në QKMF, QMF dhe AMF, duke krijuar parametrat e funksionalitetit të nevojshëm dhe plotësimin e kapaciteteve të përgjithshme për mbrojtjen shëndetësore primare. Pas 18 vjetësh tashmë kemi arritur që të kemi një avancim të strukturës organizative shëndetësore, e cila shënon etapën e kalimit në një dimension të ri veprues. Në këtë kontekst ka ndikuar pozitivisht edhe miratimi dhe fillimi i zbatimit të Statutit të ri të QKMF-së “Nënë Tereza”, i cili ka hapur definitivisht rrugën për implementimin dinamik të mjekësisë familjare dhe precizimin strukturor të përgjegjësi në sektorët dhe donacioneve, siç është Granti i Komunë e Klinës. Në këtë vit janë bërë edhe aplikimet për përfitim dhe investimi në sektorët dhe donacioneve, siç është Granti i Asistencës Bazike për Sigurinë Njerëzore të Qeverisë Japoneze, në cilin kemi arritur ta përfitim dhe investimi në Shërbimin e Urgjencës (i miratuar në parim), projekte këto, të cilat ndërlidhen në zbatimin e vijueshëm dhe në vitin 2017. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka realizuar projekte të ndryshme përmes Qendrës për Punë Sociale, duke ofruar shërbimet e nevojshme nga të dyja ekipet: Ekipi i shërbimeve sociale dhe Ekipi i asistencës sociale, të cilat kanë realizuar mbikëqyrjen e proceseve në bashkëpunim të ngushtë me: Policinë e Kosovës, gjykatat, institucionet shkollore dhe organizatat joqeveritare, për të trajtuar raste të fëmijëve pa përkujdesje prindërore, fëmijëve me aftësi të kufizuara, fëmijëve të braktisur, të adaptuar, me çrregullime martesore, si dhe angazhimin për vetëdijësimin ndaj trafikimit të qenieve njerëzore, për të rritur në gjendje konfliktoze, fëmijët me sjellje asociale dhe dhunën në familje. Synimet e realizuara vjetore, të zbatuara në bazë të menaxhimit sistematik, në kontekst të evidentimit dhe zbatimit të punëve sektoriale, vijojnë së prezantuar në vijim me statistika dhe veprimtari të konkretizuar.

Përfitimi i granteve dhe donacioneve për sektorin e shëndetësisë

Në kuadër të mundësisë për përfitim dhe granteve për sektorin e shëndetësisë në maj të këtij viti kemi aplikuar nëpërmjet Zyrës Ndërlidhëse Japoneze në Prishtinë për përfitim dhe Grantit të Asistencës Bazike për Sigurinë Njerëzore të Qeverisë Japoneze, me ç'rast është nënshkruar marrëveshja për një (1) autoambulancë standarde dhe një (1) autoambulancë për nevojat e pacientëve me hemodializë në Komunën e Klinës, si dhe pajisjet komplecte laboratorike. Në një konkurrencë të madhe nga të gjitha komunat e Kosovës, Komuna e Klinës është përzgjedhur për përfitim dhe këtij granti nga Qeveria Japoneze. Në parametrave të definuar të kriterëve për përfitim, sipas procedurave të konkurimit, koha e përgatitjes voluminoze të dokumentacionit ka përfshirë një periudhë testuese dhe verifikuese gjatshëmujore. Mbledhja dhe përgatitja e dokumentacionit ka qenë sfidë në vete për shkak të kërkesës për saktësi maksimale dhe dëshmi të shkruara për burimet dhe astetet që nga viti 2000-2016, të cilat janë kërkuar me ngulm lidhur me përcaktimin e nevojës dhe të dhënave për autoambulancat dhe aparatat laboratorike të QKMF-së. Granti arrin vlerën prej 68.229 €. Andaj, ky grant, pas konsultimit të arkivave të donacioneve, del të jetë donacioni më i madh që ka hyrë ndonjëherë në sektorin e shëndetësisë në Komunën e Klinës, i cili do të ketë ndikime pozitive, sepse krijon parametra për shërbime më cilësore shëndetësore. Në anën tjetër, DSHMS-ja ka aplikuar edhe në Ministrinë e Shëndetësisë për renovimin e hapësirave të Shërbimit të Urgjencës dhe kushteve të përfitim. Në anën tjetër, DSHMS-ja ka aplikuar edhe në Ministrinë e Shëndetësisë për renovimin e hapësirave të Shërbimit të Urgjencës dhe blejjen e pajisjeve përkatëse mjekësore për Shërbimin e Urgjencës së Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Nënë Tereza” në Klinë. Drejtoria e Urbanizimit kanë bërë planin ideor për objektin e Urgjencës, kurse ekspertët e aparatave mjekësore kanë përcaktuar nevojën e blerjes së këtyre pajisjeve: (3 copë) monitor pacientësh, (1 copë) monitor qendror, (1 copë) Holter 24 orësh komplet, (2 copë) ECG 12-kanalësh, (1 copë) defibrillator mobil me monitor, (1 copë) inhalator dhe (1 copë) aspirator, përfshirë edhe instalimin e gypave të oksigjenit dhe bocën qendrore. Pas takimit të drejtorit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Klinës me ministrin e MSh-së, z. Imet Krahmani, është arritur pajtimi që investimi prej afro 50.000 €, të realizohet në pjesën e dytë të vitit 2017.

pas rishikimit të buxhetit. Nëse MSH-ja nuk arrin të ndajë mjete financiare kemi pajtimin që këtë investim kapital ta marrë përsipër Komuna e Klinës, sepse avancimi i shërbimeve të Urgjencës është shumë i nevojshëm Gjithashtu KFOR-i italian në Pejë ka dhënë një donacion për QKMF-në: 7 krevate dhe 7 joga, financimin e pajisjeve stomatologjike në vlerë prej 3000 eurosh do të vije në fillim të vitit 2017. Në këtë kontekst, pas kërkesave tona, MSH-ja ka shqyrtuar edhe në procedurat e ndryshme institucionale e buxhetore ende nuk ka arritur ende ky realizim i paraparë. Sa i përket realizimit të Listës esenciale në vitin 2016, në bazë të faturave hyrëse në QKMF-në “Nënë Tereza” figuron se kanë hyrë 76.210.67 €, pra kemi arritur realizim afro 69.28%.

Zbatimi i Statutit të ri të QKMF-së “Nënë Tereza”

Pozitivja praktike e këtij viti të menaxhimit të sektorit shëndetësor shënon zbatimin e esencave dhe bërthamave të çështjeve që shpijnë në avancimin e kërkuar në përputhje me orientimet strategjike, ashtu siç e kemi prezantuar dhe diskutuar në takimet e Bordit të Drejtorëve, në mbledhjet e Asamblesë Komunale dhe në planifikimet e prioriteteteve të përgjithshme. Sipas predispozitave të Statutit të ri janë zgjedhur udhëheqja dhe trupat organizative të QKMF-së: Komisioni i Drejtues. Pas konstitimit të Këshillit Drejtues janë zgjedhur trupat, si në vijim: Këshilli profesional, Komisioni Disiplinor, Komisioni i Ankesave, Komiteti për Cilësi dhe Siguri të shërbimeve shëndetësore. Në këtë kontekst, miratimi dhe fillimi i zbatimit të Statutit të ri të QKMF-së “Nënë Tereza” ka hapur defnitiveisht rrugën për implementimin dinamik të mjekësisë familjare dhe precizimin strukturor të përgjegjësi në sektorët dhe nënsektorët e shëndetësisë në Komunën e Klinës. Para konstitimit të organeve drejtuese, në zbatim të Statutit të ri të QKMF-së dhe nenit 17, pika 2 të Ligjit të Punës nr. 03L-212, nenit 18, pikën 3 të Ligjit për shëndetësi nr.04L-125, nenit 23 të Rregullores nr.2015, me qëllim të ofrimit të shërbimeve shëndetësore cilësore dhe në përputhje me parimet e konceptit të Mjekësisë Familjare, drejtori i DKSHM-së ka marrë Vendimin me nr.298, dt. 13.12.2016 për ristrukturimin dhe riorganizimin e ri të punës në QKMF, QMF dhe AMF. Ndër vendimet e rëndësishme renditen edhe vendimet e tjera që po zbatohen në praktikë, si: Vendimi nr.12 për ndryshimin e orarit të punës në këto departamente, sektorë, shërbime dhe njësi të QKMF-së “Nënë Tereza” në Klinikë: Departamenti i Administratës (Shërbimi Juridik, Financiar e Teknik) – 07.00h-15.00h; Departamenti i Mjekësisë Familjare (Sektori i Mjekësisë Familjare, Sistemi Informativ Shëndetësor – SISH, Vaksinimi, Shëndeti Oral, Urgjencia, Diagnostika, Kabineti Radiologjik dhe Laboratori) - 07.00h-15.00h; Shërbimi Specialistik (internisti, psikiatri, neuropsikiatri, oftamologu, infektologu, gjinekologu, pneumoftziologu dhe fiziatri) 07.00h-15.00h. Vendimi nr.24 për organizimin e punës në dy ndërrime në sektorët dhe njësitë, si vijojnë: Mjekësinë Familjare, Shërbimin e Vaksinimit, Pediatrisë, Laboratorit, Urgjencës, Sportelit dhe Barnatores (07-14.00h, 13.00-19.00h).

Vendimi nr. 29 për mbulimin e tre QMF-ve dhe nëntë AMF-ve me personel profesional dhe teknikë shëndetësorë - 07-15.00h.

Në mesin e vendimeve që janë shqyrtuar dhe vlerësuar realisht dhe, për të cilin, konkludojmë se kemi arritur transparencë të gjithanshme është ai lidhur me shërbimet e ofruara dhe koston e lartë të Maternitetit të QKMF-së “Nënë Tereza” në Klinikë, ku në të kaluarën kanë punuar 3 gjinekologë dhe 8 motra medicinale, kurse me strukturimin e ri është shndërruar në Shërbim Gjinekologjik (2 gjinekologë dhe 2 motra), ndërsa 7 motra medicinale janë transferuar në sektorët e tjerë, me ç'rast janë mënjeluar shpenzimet e mëdha. Shpenzimi i buxhetit për vitin 2017 është liru prej afro 16-18.000 €, përfshirë heqjen e gjendjes së gatishmërisë për gjinekologët, kujdestaritë e stafit dhe llojet specifike të medikamenteve, të cilat do të orientohen për nevoja të tjera shëndetësore. Edhe këtë vit janë ofruar shërbime dhe vizita shëndetësore për qytetarët e Komunës, të cilat janë si më poshtë: 112.387 shërbime dhe 116.538 vizita. Gjithashtu edhe Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional dhe nevoja e sigurimit të pikëve licencuese të personelit mjekësor, i bazuar në dispozitat e Nenet 75 të

Ligjit për Shëndetësi nr.04/L-125, me qëllim të ruajtjes dhe ngritjes së kualifikimeve të tyre profesionale, ka vazhduar përgjatë vitit, me ç'rast janë krijuar mundësitë e aftësimit të nevojshëm dhe përgatitjes së kuađrove me rritje dhe evoluimet e ndryshme në fushën e shëndetësisë.

Rritja e cilësisë së shërbimeve dhe veprimtaritë vetëdijëse shëndetësore

Në aspektin e rritjes së cilësisë së shërbimeve ka vijuar mbikëqyrja e punës dhe e zbatimit të dokumentacionit unik shëndetësor, sipas udhëzimeve administrative për shëndetësi për plotësimin e fletëve kompjuterike, recetave dhe evidencave korrekte të protokoleve, kartonëve shëndetësorë për përdorimin e mbikëqyrja e vazhdueshme e higjienës. Gjithashtu ka pasur edhe aktivitetet lidhur me vetëdijësimin qytetar për sëmundje të ndryshme, me ç'rast janë mbajtur trajnime adekuat: prill-maj; Trajnimi në bashkëpunim me KFOR-in për vetëdijësimin e popullatës për ethet hemorragjike dhe qershor-korrik-shtator-tetor: aktivitetet për vetëdijësimin për gjdhënie dhe shëndetin oral. Tetor: Aktivitet vetëdijësues për kancerin e gjirit në bashkëpunim me OJQ "Zana". Nëntor: Punëtori për përdorimin e fletëzave kompjuterike, e organizuar nga SISH-i. Dhjetor: Ligjëratë vetëdijësuese për kancerin e gjirit në bashkëpunim me OJQ "Zana". Nëntor: Punëtori për përdorimin e mbikëqyrjen e gjendjes në terren, qasjen ndaj problematikave, temat e prezantuara në sesione, diskutimet dhe vendimet për planifikimin e ardhshëm. Këto rreth shëndetit dhe kujdesit të fëmijëve. OJQ "Save the Children në bashkëpunim me Komunën e Klinës dhe në veçanti me QKMF-në kanë identifikuar tema dhe me kujdes të veçantë kanë punuar në përgatitjen dhe organizimin e aktiviteteve të shumta edukuese e informuese. Kujdes i veçantë i është kushtuar kujdesit të fëmijëve që nga faza para lindjes dhe duke e përcjellur atë në etapat e rëndësishme të rritjes së tyre. Shqubhen temat çfarë duhet të dijnë nënat para lindjes, të ushqyerit me qumësht të gjirit, kolla apo ftohjet të fëmijët, higjiena orale dhe vaksinimi. Sesionet janë mbajtur në dy lokacione: në shkollën fillore të fshatit Zajm dhe në Çerdhen "Xhevë LLadrovcj" në Klinë me fëmijë deri në moshën 5 vjeçare, të shoqëruar me nënat e tyre. Pjesëmarrja ka qenë e kënaqshme dhe temat janë pëlqyer shumë. Gatishmëri bashkëpunimi është treguar me secilën organizatë që ndihmon dhe kontribuon në realizimin e projekteve të dobishme për banorët e Klinës.

Transparenca

Edhe pse që nga data 22.04.2014 kemi dërguar Informatën nr.75 për aktivitetet e zhvilluara lidhur me asgjësimin e mbeturinave të produkteve medicinale, të mbledhura para vitit 2014, me anë të së cilës kemi kërkuar nga Ministria e Shëndetësisë që të ndërmarrë veprimet e nevojshme ligjore për asgjësimin e tyre, sepse kjo çështje nuk është në domenin lokal të kompetencave tona, ne, prapëseprapë, ende mbesim pezull dhe nuk kemi marrë përgjigje. Në informacionin e dërguar në MSH kemi bashkëngjitur regjistrin e mbeturinave të produkteve medicinale, vendin e magazinimit, llojin e tyre, datën e skadimit, numrin e paketimit dhe sasinë. Meqë këto mbeturina zënë një hapësirë të konsiderueshme të objekteve shëndetësore dhe konsiderohen të rrezikshme presim që të marrim informacionin për ndërmarrjen e procedurave të asgjësimit të tyre. Zhvillimi i transparencës në veprimtarinë shëndetësore është realizuar përmes zbatimit të Ligjit nr.03/L-215 për qasje në dokumente publike, neni 4,5 dhe 6, me ç'rast përmes Zyrë së Informimit të Komunës së Klinës kemi pranuar dy kërkesa nga OJQ "Koha" dhe kemi dërguar shënimet përkatëse për: 1. Të dhënat/shumat për të hyrat financiare të inkasuara nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF), Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) dhe Ambulancat e Mjekësisë Familjare (AMF) gjatë muajit tetor dhe tetor-dhjetor 2016; 2. Këto të dhëna

duhet të përmbajnë: a. Kategorizimin e të dhënave financiare për çdo njësi e cila ofron shërbime mjekësore dhe b. Emërtimin e shërbimit dhe shumat për çdo kategori shërbimi. Kemi dërguar të dhënat e përkrahura më lart nën pikën 1 dhe 2, të Shkresës së tyre të datës 01.09.2016, për njësitë punuese, participimin përshimin edhe: a) Emërtimin e llojit të vizitës/kontrollit....” kemi kërkuar që kjo të realizohet me anë të qajes së tyre në dokumentacionin evidentues, sepse realizimi i kërkesës nën pikën 3 është një punë procedurale pothuajse disajvore, me ç’rast kërkohet themelimi i një komisioni të veçantë për të hyrë në librat shëndetësorë dhe historitë e pacientëve për të nxjerrë të dhënat e secilit pacientë dhe pagesat që kanë bërë ata, kështu që për t’ua lehtësuar punën kërkimore zyrtarëve të OJQ-së “Koha”, DKSHMS-ja ka mundësuar qasjen e plotë zyrtarëve të saj në librat shëndetësorë dhe të mbikëqyrë procesin e faturimit, nga ku edhe kemi bërë nxjerrjen e të dhënave financiare të kërkuara. Lidhur me këtë është njoftuar OJQ “KOHA” që nëse ka ekip, kohë dhe vullnet të mirë mund ta bëjë verifikimin e llojit të vizitës/kontrollit në secilën njësi punuese shëndetësore. Përfaqësuesit e sektorit shëndetësor kanë marrë pjesë në sesionet e hartimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik 2017-2021, duke dhënë kontributin e kërkuar profesional e menaxhues, me ç’rast ka reflektuar një qartësi dhe konkretësi e vizionit të zbatueshmërisë strategjike të avancimit të këtij sektori në të ardhmen. Vlen të përmendet projektimi dhe riorganizimi i Mjekësisë Familjare që parashihet në strategji, në ndajet dhe nënndarjet strikte dhe praktike, duke marrë për bazë edhe evolucionet e reja, që do të fillojnë së aplikuari me Ligjin për sigurime mirëmenaxhojmë shpenzimet në këtë segment dhe mund të themi se kemi arritur kuotat më të ulëta të shpenzimit të mundshëm në saje të mbikëqyrjes dhe menaxhimit sistematik të kartelave të secilit automjet. Kështu, kuota mujore më e ulët e shpenzimit arrin në muajin prill me vetëm 1300 litra të shpenzuara dhe në muajin nëntor 1355 litra.

Si sfida të çështjeve shëndetësore lokale për vitin 2017 mbesin edhe më tej realizimi i mangët i listës esenciale nga ana e MSH-së. S’do të mund të gjcni shtete në botë, qofshin edhe ato që vuajnë nga varfëria dhe uria e madhe, që s’e kanë zgjidhur, ta marrim shembull, sigurimin e Insulinës, përveç të tjerave, edhe +10% të rezervës së saj. Jo vetëm në rastin e këtij medikamenti esencjal për jetën e qytetarit, por ka shumangia të theksuara edhe në realizimin e përgjithshëm sasior dhe cilësor të listës esenciale. Rreziqet e mëtejshme potenciale që kuptohen nga raportet dhe pasqyrat vjetore të menaxhimit të institucioneve shëndetësore primare vijnë nga dualizmat e shërbimeve të ofruara në insitucionet publike dhe private shëndetësore, pastaj tendencat jokoordinuese në kolegjiune dhe komisione profesionale shëndetësore, zbatimi i parimeve etike gjatë ushtrimit të veprimtarisë shëndetësore dhe mosaplikimi i Ligjit për sigurime shëndetësore (i miratuar në prill 2014), i cili do të siguronte qëndrueshmëri në vijën horizontale dhe vërtikale të marrjes së shërbimeve të cilësore.

Në Shërbime Sociale në Qendrën për Punë Sociale janë kryer gjithsej 417 shërbime gjatë vitit 2016, në këto shërbime përfshihen nga këshillimi deri të përkrahja për familjet me probleme familjare, mbrojtja e fëmijëve, mbrojtja e të moshuarve, si dhe shërbime të tjera shtesë administrative (vërtetime, deklarata të ndryshme dhe shkresa të tjera). Në Shërbimin Social në Qendrën për Punë Sociale janë të punësuar 4 zyrtarë, përfshirë edhe udhëheqësin e Shërbimeve Sociale, të cilët janë të licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Këta zyrtarë gjatë vitit 2016 janë pajisur me kompjuterë, ulëse të reja dhe material tjetër përcjellës të shfrytëzueshëm. Nga puna e këtyre zyrtarëve janë grumbulluar ma shume se 3500 euro, si taksa administrative, të cilat paguhen në arkën e komunës, për vërtetimet që lëshohen me pagesë. Gjithashtu këta zyrtarë i kanë përcjell trajnimet në mënyrë të rregullit, të organizuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, si dhe organizata të ndryshme joqeveritare. Gjatë veprimtarisë ka pasur bashkëpunim me Policinë e Kosovës, Prokurorinë e

Kosovës, Gjykatën Themelore në Pejë - Dega Klinë, dhe me OJQ të ndryshme (Save the Children, Caritas-in etj). Meqë Qendra për Punë Sociale ishte përzgjedhur si pilot-projekt nga "Save the Children është zhvilluar një vizitë studimore në Bukuresht, ku bashkë me Ferizajn dhe Prishtinën, ku janë siguruar informacione për mbrojtjen e fëmijëve dhe forma të tjera të mbrojtjes së familjeve me probleme të ndryshme familjare. Shërbimet Sociale kanë realizuar vizitat në familje, të cilat kanë fëmijë me nevoja të veçanta, fëmijë në strehim familjar dhe fëmijë në kujdestari. Gjatë vitit 2016 është strehuar një i moshuar i gjinisë mashkull, pa përkujdesje familjare, në strehimorin për të moshuar në Skënderaj, gjithashtu, një e moshuar e gjinisë femër në strehimorin në Gurakoc të Istogut, e cila nuk ka përkujdesje familjare. Në këtë kontekst, komuna e Klinës ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me komunat e regjionit të Dukagjinit për përkrahje financiare për strehimorin e viktimave të dhunës në familje në Pejë, ngaqë aty strehohen viktimat e dhunës, me ç'rast janë strehuar 7 raste si viktimat e dhunës në familje, njeri nga këto raste është strehuar në strehimorin e Gjakovës. Viktimat e këtyre rasteve vizitohen dhe këshillohen nga ana jonë deri në përmirësimin e mundshëm të raporteve familjare. Nëse ndonjëri nga rastet ka nevojë për ndihmë juridike, atëherë drejtohet në Zyrën për ndihmë juridike falas në Pejë. Gjatë vitit 2016 është përzgjedhur një familje strehuese, e cila ka shprehur gatishmëri të bëjë strehimin dhe mbikëqyrjen e fëmijëve pa përkujdesje prindërore.

Në Shërbimin e Asistencës Sociale, pasi MPMS-ja ka krijuar skema të reja, si ajo e veteranëve dhe personave të verbër, Qendra Sociale ka bashkëpunuar pa Departamentin e Politikave Sociale dhe Familjare në kuadër të MPMS-së, në mënyrë që nga këto skema të largohen përfituesit e ndihmave sociale. Nga këto dy skema janë larguar afro 150 familje, të cilat kanë përfitur ndihmë sociale deri me tani. Numri i përfituesve të ndihmave ka lëvizur nga 780 deri 810 familje përfituese, kurse në bashkëpunim me MPMS-në dhe organizatat joqeveritare kemi ndihmuar 200 familje me pako të ndryshme veshmbathjesh. Qendra ka ndihmuar 4 familje me pako ushqimore nga buxheti vetanak, vlera e të cilave arrin afro 300 euro, këto mjete, që janë paguar nga shërbimet dhe malltrat.

Projekte me zbatim vijues

Projekti "Rëndësia e kujdesit dhe zhvillimit gjatë fëmijërisë së hershme" vijon së zbatuari në bashkëpunim me "Save the Children". DSHMS-ja ka caktuar ekipin shëndetësor dhe ekipin social për ofrimin e shërbimeve të nevojshme në këtë projekt. Edhe projekti i financuar nga OKB-ja për zhvillimin e Programit Riintegrues Social për gratë dhe fëmijët – viktimat të dhunës në familje dhe trafikimit njerëzor është duke u zbatuar nga Qendra Sociale. Sipas Programit të Republikës së Kosovës kundër dhunës në familje dhe planit të veprimit duhet të krijohen programe kreditimi të viktimave për të rifilluar një aktivitet ekonomik të nxiten programe për fuqizimin e familjes, programe të punësimit, formimit profesional, ndërmjetësimit për viktimat e dhunës dhe ushtruesit e dhunës në familje, ngritja dhe zbatimi i programeve nëpër shkolla dhe komunitete për parandalimin e dhunës në familje dhe çështje të tjera. Projekti i zbatimit të Planit kombëtar për parandalimin dhe eliminimin të dhunës në familje dhe çështje të tjera. Puna e fëmijëve është një dukuri e pranishme në Kosovë dhe ka një ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin, shkollimin dhe zhvillimin normal të tyre. Andaj, Qendra Sociale në Klinë në bashkëveprim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka zbatuar Strategjinë dhe Planin e veprimit për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve (PEPF).

Si sfida të çështjeve sociale për vitin 2017 mbesim: sigurimi i një buxheti për shërbime sociale komunale, kthimi i pagesave, të cilat po bëhen nga palët e Qendrës Sociale në llogari të Drejtorisë së Administratës, të cilat duhet të bëhen në llogari të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, kthimi i fondit për nevojtarë nga Drejtoria për Emergjencë në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, saktësisht në Qendër Sociale, sepse vetëm Qendra Sociale punon me familje në nevojë.

DREJTORIA E ARSIMIT

Përmbledhje

Në periudhën janar-dhjetor 2016 Drejtoria e Arsimit ka kryer punë, ka realizuar dhe ka bashkërenduar aktivitete e projekte të ndryshme në përputhje me parimet dhe qëllimet e Ligjit të Arsimit Parauniversitar në Republikën e Kosovës, të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, pastaj mbështetur dhe të problemeve që kanë kërkuar zgjidhje.

Aktivitetet kryesore të Drejtorisë në këtë vit kanë qenë të koordinuara dhe të orientuara në këto fusha:

1. Ngrija e shkallës së cilësisë në procesin mësimor
2. Zgjerimi i hapësirave shkollore
3. Trajnimi i vazhdueshëm i personelit të shkollave
4. Gjithëpërfshirja në arsim
5. Organizimi i garave, konkurseve dhe olimpiadave të ndryshme për nxënës
6. Koordinimi i aktiviteteve me MASHT-in për organizimin dhe administrimin e vlerësimit të jashtëm.

Bashkëpunimi me partnerë kompetentë dhe me palë të ndryshme të interesit në arsim, po ashtu ka ndikuar që të kemi një performancë më të mirë në institucionet arsimore sa i përket vetëdijesimit të nxënësve për natyrën dhe rëndësinë e të drejtave të fëmijëve dhe të njeriut, pastaj për kulturën ekologjike dhe shkolla për vetëdijesimin e nxënësve për t'i mënjeluar pasojat nga trafiku dhe ligjëratat e ndryshme kundër dukurive të këqija dhe pasojave nga to, siç janë droga, trafikimi me qenie njerëzore etj. Në këtë drejtim na ka ndihmuar Policia e Kosovës, FSK-ja, KFOR-i, OSBE-ja dhe OJQ të ndryshme që trajtojnë praktika të tilla.

Gjatë kohës dimërore të gjitha shkollat kanë qenë mirë të furnizuara me lëndë për ngrohje (dru, thëngjill, naftë) dhe Drejtoria me kohë ka bërë që të kontrollohen dhe të mirëmbahen në rregull sistemet e ngrohjes në çdo shkollë.

Gjatë vitit 2016, me propozim të DKA-së, kanë kaluar nëpër procedurat zyrtare dhe janë miratuar nga Asambleja Komunale tri dokumente të rëndësishme për arsimin e Klinës: Rregullorja unike për nxënës dhe personel të institucioneve arsimore, Rregullorja për dhënie të bursave studentëve të Komunës së Klinës, Plani Zhvillimor i Arsimit 2017/2019.

Trajnimet në mbështetje të procesit të mësimdhënies dhe të nxënies

Sikur edhe viteve të tjera, edhe gjatë vitit 2016 DKA-ja ka bashkëpunuar dhe ka koordinuar aktivitete me MASHT-in dhe me institucione të akredituara për realizimin e trajnimeve profesionale që kanë pasur në fokus përmirësimin dhe avancimin e procesit të mësimdhënies dhe të nxënies. Nga trajnimet më të rëndësishme që janë mbajtur gjatë vitit 2016 po përmendim:

- Nga MASHT-i: trajnime për zbatimin e Kurrikulës, trajnime për koordinatorë të cilësisë të tri shkollave pilot dhe për koordinatorin komunal.
- Nga Instituti Pedagogjik i Kosovës (IPK) dhe DKA-ja: trajnimi me pjesëmarrës nga të gjitha shkollat për vlerësimin e brendshëm të shkollës.
- Nga organizata “Save the Children”: trajnime me edukatorë të nivelit 0 për gjithëpërfshirje, për të drejtat e fëmijëve, për planin individual të arsimit (PIA), për metodologjitë arsimore.
- Nga MASHT-i dhe ECMI-ja: trajnim për drejtorë shkollash lidhur me përdorimin e programit SMIA.
- Nga KEC-i: trajnimi me mësimdhënës dhe nxënës të katër shkollave “Ndërmjetësimi mes bashkëmoshatarëve”, aktivitet në kuadër të zbatimit të Rregullores 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e rasteve të dhunës në shkolla.
- Nga GIZ-i: trajnimi për vlerësimin përmbledhës-hartimin e testit, trajnimi për mësimdhënien e Matematikës (kl.1-5).
- Nga USAID (BEP): vlerësimi formativ.
- Nga OJQ “Syri i vizionit”: trajnimi me mësimdhënës për këshillimin dhe edukimin në karrierë.
- Nga BIT Kosova: trajnimi për projektin e MASHT-it e-edukimi.
- Nga Caritasi zviceran: trajnimi me edukatorë të paraleleve parafillore “Edukimi përmes lojës”.
- Nga AUK-u (mbështetur nga MASHT-i dhe GIZ-i): trajnimi për udhëheqje arsimore.
- Nga BEP-i: trajnimi A-egra (vështirësitë e leximit të nxënësit e klasave të hershme).

Bashkëpunimi dhe koordinimi

Drejtoria e Arsimit, si edhe në periudhat e mëhershme të aktiviteteve të saj, edhe në këtë vit ka bashkëpunuar dhe ka koordinuar punë e aktivitete, përpos me struktura të pushtetit lokal dhe qendror, konform detyrave dhe përgjegjësiive ligjore, edhe me partnerë dhe palë të ndryshme të interesit në arsim, me organizata të ndryshme qeveritare e joqeveritare dhe në sja të një bashkëpunimi të tillë është ngritur shkalla e performancës në shërbimet e Drejtorisë dhe në institucionet

edukativo-arsimore. Në këtë drejtim duhen përmendur: Policia e Kosovës, FSK-ja, UNICEF-i, KFOR-i, USAID-i, GIZ-i, OSBE-ja, BIT Koosva, Instituti Pedagogjik i Kosovës, Save the children, Caritasi zviceran, ECMI-ja, Shoqata Matematike e Kosovës.

Në kuadër të bashkëpunimit me MASHT-in dhe me mekanizma ndërkombëtarë të BE-së gjatë vitit 2016 janë mbajtur disa aktivitete të rëndësishme arsimore, ku vlen të përmenden disa konferenca, si: konferenca për sigurimin e cilësisë së performancës së shkollës, organizuar nga MASHT-i dhe IPK-ja; konferenca për vlerësimin e nxënësve sipas Kurrikulës së re, organizuar nga MASHT-i dhe Projekti i binjakëzimit, ku kanë marrë pjesë zyrtarë të DKA-së, mësimdhënës dhe drejtorë shkollash.

Sa i përket zgjerimit të hapësirave shkollore, në vitin 2016 ka përfunduar ndërtimi i objekteve shkollore në Jashanicë dhe në Përçevë, kurse objekti shkollor i Këpuzit është në fazën përfundimtare.

Gjatë vitit 2016 kemi realizuar këto ndërtime dhe renovime:

- Ndërtimi i sistemit të ngrohjes qendrore në gjimnazin “Luigj Gurakuqi” në Klinë, në vlerë prej 39666 €.
- Renovimi i objektit shkollor në Budisalc (ndërtimi i dverve dhe i një pjese të dritareve-donacion nga KFOR-i italian (6800 €); renovimi i jashtëm i objektit nga buxheti i Komunës, me vlerë 3770.60 €.
- Ndërtimi i fushës sportive në shkollën e Shtupelit, projekt i realizuar nga IOM-i në bashkëpunim me DKA-në, me vlerë prej 7412 €, prej tyre 1412 nga DKA-ja.
- Ndërtimi i pusit në shkollën e Ujmirit, me vlerë prej 3550 €.

Në prill 2016 ka filluar procesi edukativ në objektin e ri të Çerdhes së fëmijëve-projekt i përbashkët i Komunës dhe organizatës Save the children. DKA-ja ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi që kjo organizatë ta bëjë financimin e një edukatoreje për fëmijë me nevoja të veçanta në Çerdhe deri më 31 dhjetor 2017, me mundësi të vazhdimit pastaj nga ana e DKA-së. Në këtë vit po ashtu kemi nënshkruar një memorandum me Caritasin zviceran për ofrimin e shërbimeve në edukimin parashkollor (pajisje didaktike, inventar, trajnime etj.)

Caritasi zviceran ka pajisur me inventar dhe lodra dy klasa të reja të parafillorëve në shkollën “Ismet Rraci” dhe në Gllarevë si dhe gjashtë klasa të tjera ekzistuese (në Grabanicë, Cerovik, Gremnik, Sferkë, Zllakuqan dhe Çabiq).

Në kuadër të gjithëpërfshirjes dhe të ngritjes së cilësisë në arsimin parauniversitar, Komuna ka nënshkruar një marrëveshje me organizatën “Terre des hommes”, ku është paraparë hapja e një klase shtesë në SHFMU “Nënë Tereza” në Budisalc me nxënës që kanë vështrësi në nxënie (nxënës të komunitetit RAE dhe shqiptarë). Kjo klasë ka filluar të funksionojë më 15 tetor 2016 dhe do të jetë e hapur deri më 31 dhjetor 2019. Pedagogjen që punon me këta nxënës, sipas marrëveshjes, e paguan organizata “Terre des hommes”.

Kompania IPKO ka furnizuar Çerdhen e fëmijëve në Klinë me pajisje të ndryshme me vlerë prej 1000€, kurse në shkollën e Gllarevës ka investuar me 1000€ për ndërrimin e 4 dyerve dhe për pajisje didaktike. GIZ-i ka pajisur 14 shkolla me mjete didaktike, si përkrahje për hartimin e planeve zhvillimore. Projekti i binjakëzimit ka pajisur tri shkollat pilot të Kurrikulës me tabela shkollore dhe pajisje të ndryshme mësimore.

DKA-ja edhe gjatë këtij viti i ka bërë kërkesë MASHT-it për ndërtim të objektit shkollor të shkollës “Ismet Rraci” dhe në kuadër të kësaj çështjeje Kryetari i Komunës, z. Sokol Bashota, ka formuar një komision të përbërë nga zyrtarë të Urbanizmit dhe të DKA-së për të vlerësuar gjendjen faktike fizike të objektit shkollor të shkollës “Ismet Rraci” dhe raportit i këtij komisioni iu është dërguar, së bashku me përsëritjen e kërkesës për ndërtim, tri organeve qendrore: Kryetari të Kuvendit të Kosovës, Kryeministri dhe MASHT-it. Qeveria u angazhua maksimalisht për këtë çështje, siguroi mjetet financiare dhe filloi procedurat për ndërtimin e objektit shkollor të shkollës fillore e të mesme të ulët “Ismet Rraci” në Klinë. Në fund të dhjetorit solemnisht u hodh gur themeli për ndërtimin e këtij objekti të rëndësishëm shkollor.

Në vitin shkollor 2016/2017, pas analizës së gjendjes dhe sigurimit të mjeteve financiare, DKA-ja ka hapur pesë paralele parafillore në shkollat: Jashanicë e Epërme, Jagodë, Përçevë, Valljak, Siqevë.

Vlerësimet e jashtme, garat, konkurset dhe olimpiadat e ndryshme

Testi i arritshmërisë për klasën 9 është mbajtur më datën 21.5.2016. Hynë në testim 879 nxënës, arritshmëria është 53.24. Testi i maturës shtetërore është organizuar në dy afate nga dy pjesë.

Pjesa e parë e testit të maturës apo afati kryesor është mbajtur më datat 4, 18.6.2016; në afatin e qershorit kalueshmëria është 60%.

Në këtë vit kalendari po ashtu janë mbajtur aktivitetet të shumta jashtëshkollore, gara dhe olimpiada të natyrave të ndryshme, siç janë: Olimpiada Matematike e Kosovës, konkursi “Gjuhëtari i ri”, garat e kimit dhe të anglishtes, të organizuara nga kolegjii “Mehmet Akif”, gara e inteligjencës “Eureka”, organizuar nga gjimnazi “Hasan Nahi” (Prishtinë), garat ndër-kombëtare të anglishtes, organizuar nga Korpusi Amerikan i Pages.

Shënime të përmbledhura për nxënësit dhe personelin për vitin shkollor 2016/2017

Në vitin shkollor 2016/2017 në Komunën e Klinës kanë funksionuar si institucione arsimore publike 17 shkolla amë fillore, 9 paralele të ndara; dy shkolla të mesme të larta (gjimnazi dhe shkolla profesionale) dhe një Kopsht i fëmijëve. Në Klinë funksionon edhe shkolla e mesme private e mjekësisë “Keka Med” dhe një Kopsht i fëmijëve publiko-privat në Zllakuqan. Në këtë vit shkollor (2016/2017), sipas të dhënave të programit SMIA të MASHT-it, në institucionet edukativo-arsimore publike vijnë 8621 nxënës, prej tyre nxënës REA janë 258 ose 3%. Në sektorin e arsimit, në të gjitha institucionet edukativo-arsimore, janë të punësuar 650 punëtorë, prej tyre 532 mësimdhënës. Femra të punësuar janë 223 ose 34 % (209 mësimdhënës). Moshë mesatare e mësimdhënësve

35

është 46 vjeçe. Numri i nxënësve femra në nivel komune është 5253 ose 60.9 %. Në nivelin 0,1 dhe 2 të arsimit vijnë 3323 nxënës femra ose 49.7 %, kurse në nivelin 3 vijnë 965 nxënës femra ose 53.2 % (në gjimnaz 74 %; në SHMP 31 %).

Në fund të vitit shkollor 2015/2016, sipas të dhënave të programit SMIA, kalueshmëria në nivel komunal është si vijon më poshtë:

1. Klasa 1-5: 96.99%.
2. Klasa 6-9: 92.99%.
3. Klasa 10-12: 95.14%. Nota mesatare është 3.9 .

Kurse në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2016/2017 është si vijon:

1. Klasa 1-5: 90.43 %.
2. Klasa 6-9: 77.15 %.
3. Klasa 10-12: 33.39 %. Nota mesatare është 3.68

Drejtoria Komunale e Arsimit, sikur edhe deri më tash, edhe gjatë vitit 2016 ka menaxhuar dhe koordinuar veprimet me drejtorët e institucioneve edukative e arsimit, ashtu si kërkohet nga dispozitat ligjore, nga dokumentet strategjike të Komunës dhe të MASHT-it si dhe nga të gjitha dokumentet dhe aktet e tjera zyrtare të Kurrikulës së re të Republikës së Kosovës.

DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit pranë Komunës së Klinës gjithë fushë veprimtarin e vet e ushtron në bazë të dispozitave Ligjore, rregulloreve që janë në fuqi, dhe është ekzekutuese e drejtpërdrejt e Vendimeve të Asamblesë Komunale

Në kuadër të Drejtorisë për Urbanizëm, dhe Mbrojtje të Mjedisit vepron:

Shërbimi i ndërtimit dhe Banimit

Zyra për Mjedis

Planifikimi Urban

Zyra për Projekte

Në kuadër të kësaj drejtorie ushtrohen këto veprimtari:

- Punët dhe aktivitetet rreth ndërtimit dhe banimit
- Legalizimi
- Punët dhe aktivitetet rreth Urbanizmit –Planifikim
- Pajisja me leje mjedisore komunale.
- Hartim të gjitha paramasave, paralogaritë, raporteve dhe projekt propozimeve për donator.
- Mbikëqyrja e ecurisë së punimeve, në pranimit teknike për të gjitha projektet që janë në kuadër të kësaj drejtorie, në inspektime në teren sipas kërkesave të paletë.

Gjatë vitit 2016

Në këtë Drejtori janë pranuar gjithsej 344, kërkesa prej të cilave 224, janë vendosur (miratuar), 88 të pashqyrtuar, kurs në procedurë janë 24 lende, cilat duhet kompletohen me dokumentacion shtesë.2 të refuzuara dhe 6 të hedhuara posht.

Nga lëshimi i Lejeve ndërtimore, Lejeve mjedisore, Kushteve të ndërtimit, pëlqimeve, vërtetimeve nga ana e kësaj drejtorie janë krijuar të hyrat buxhetore në vlerë prej 57,066.53 €.

Projektit:

Gjatë vitit 2016 janë hartuar dhe përpunuar parametat me paralogarit, është bërë ndërtimi-realizimi i projekteve infrastrukturore, dhe ndërtime tjera (objekte) në Komunën e Klinës siç vijon:

Asfaltimi i rrugëve gjatë vitit 2016

1. Ndërtimi i sheshit të qytetit.
2. Asfaltimi i rrugëve në qytet
3. Asfaltimi i rrugës në Dugujev të Kisha.
4. Asfaltimi i rrugës në Gjurgjevik të Madhë
5. Asfaltimi i rrugës në Kermic-Vazhvim 2017.
6. Asfaltimi i rrugëve "Syl Palushi", "Osman Krasniqi", "Mic Sokoli" dhe "Kuvendi i Lezhës" -brenda Qytetit
7. Asfaltimi i rrugës Stup-Zajmë –Vazhdim 2017.
8. Asfaltimi i rrugës Rudicë.
9. Asfaltimi i rrugës Klinafë.
10. Asfaltimi i rrugës Kermic faza II.
11. Asfaltimi i rrugës Gjurgjevik i madh faza II.
12. Bazamenti i sheshit "Ndue Perlleshi"
13. Ndërtimi i Urës Ranoc
14. Rehabilitimi i shtratit të lumit Klina.
15. Projektimi i projekteve infrastrukturore
16. Mbikëqyrja e sheshit .

Ndërtim i objekteve

1. Vazhdimi i ndërtimit të objektit banesor P+6k.
2. Përfundimi i ndërtimit të shkollës Sferkë,
3. Përfundimi i ndërtimit të shkollës Perqevë dhe Jashanicë
3. Përfundimi i ndërtimit të çerdhës së Fëmijëve në Klinë

Kanalizime

1. Poterq i lart faza II.
2. Gremnik faza III.
3. Budisalc faza II.

Gjatë këtij viti janë mbajtur takime të ndryshme me donator të ndryshme si dhe dikasteret e linjës me qëllim të harmonizimit të punëve si dhe përfundimit të projekteve të ndryshme,

Drejtoria për Urbanizim dhe Mbrojtje ete mjedisit gjatë vitit 2016 ka bërë edhe punë tjera nga lamiya e inspektimit , mbikëqyrjet dhe pranimet teknike të projekteve të realizuara në komunën e Klinës.

DREJTORIA E BUJQËSISË

Fillimisht është bërë plani i punës për vitin 2016 në bazë të cilit Drejtoria e Bujqësisë do të kryejë të gjitha punët dhe aktivitetet saj. Duke pas parasysh se mbjelljet pranverore fillojnë në fillim të vitit nëse si drejtori e kemi përgatitur planin e mbjelljeve pranverore të cilin në vazhdim do të paraqesim në formë tabelore:

Nr.	Kultura	Sipërfaqet planifikuar /ha	Sipërfaqet realizuara/ha	e
1	Misër	2930	2920	
2	Tërshërë	385	380	
3	Perime	215	211	
4	Patate	130	120	
5	Bimë foragjere	725	720	
6	Të tjera	60	55	
	Gjithsej	4445	4406	

Siç shihet nga tabela plani i mbjelljeve është realizuar gati në tërësi me disa ndryshime të vogla sipas kulturave dhe sipërfaqeve të mbjella. Dinamika e punëve ishte tejte voluminoze fillimisht me fermerët të cilët kanë aplikuar për subvencione të Grurit, Misrit, Pemëve, Perimeve, Lopëve qumështore, Deleve, Dhive, Dosave, Bletëve, Qumështit si dhe realizimin e projekteve nga Komuna.

Me fillimin e aplikimit të subvencioneve ne si drejtori paraprakisht i kemi njoftuar fermerët për afatin dhe për dokumentacionin e nevojshëm për aplikim dhe gjatë kësaj periudhe procesi ka shkuar mirë, interesimi i fermerëve ka qenë i madhe dhe çdo vite është në rritje. Kësaj i ka kontribuar edhe subvencionimi nga Ministria e Bujqësisë dhe mbështetja nga Komuna.

Për vitin 2016 në komunën tonë kanë aplikuar gjithsejtë 997 fermer për të gjitha llojet e subvencioneve. Ne si drejtori kemi përcjell edhe fushatën e korrije shirjeve gjatë gjithë kohës, gjendjen teknike te autokombajnave dhe njëkohësisht i kemi këshilluar për mos

djegjen e sipërfaqeve të korrura (hamulloreve).në këtë fushatë kanë qenë të angazhuara 104 autokombajna dhe fushata e korrije shirjeve është kryer brenda afatit të paraparë.

Rendimenti i grurit ketë vit ka qenë më i lart në krahasim me vitin e kaluar e që në mesatare është 4630 ndërsa të elbi rendimenti ka qenë 3850kg /ha. Gjatë këtij viti jemi ballafaquar më sëmundjen e gungore të gjedheve .

Lidhur më këtë gjendje është formuar komisionin për monitorimin e gjendjes dhe ndërmarrjen e masave emergjente në të gjitha rastet e lajmëruar nga veterinarët e terrenit dhe fermerët.

Në komunën ton kemi gjithsej 11 raste të ngordhjes së gjedheve nga kjo sëmundje dhe kryesisht lopë qumështore.

Kemi përgatit raportet nga terreni me procesverbale dhe të njëjtat i kemi dërguar të inspektorët veterinar në Pejë.

Për vitin 2016 nga Komuna e Klinës në fushën e bujqësisë janë kryer këto projekte:

Ndërtimi i kanalit të ujitjes në fshatin Krushevë të Madhe në gjatësi prej 1350 m. Nga ky kanal ujitën 350 ha tokë bujqësore .

Ndërtimi i kanalit të ujitjes në fshatin Gremnik në gjatësi 1738 metra. Nga ky kanal ujitën 70 ha tokë bujqësore

Ndërtimi i kanalit të ujitjes në fshatin Grabanicë bashkëfinansim me MBPZHR ku Komuna ka participuar me 20 % në. Gjatësia e këtij kanali është 2900 m.

Nga ky kanal ujitën 150 ha tokë bujqësore

Këtë vit është në fazën fillestare të ndërtimit kanali i ujitjes së tokave bujqësore nga fshati Stup, Budisalc dhe Krushevë e Madhe në gjatësi 42.50 metra. Ky projekt financohet me 80 % nga MBPZHR dhe me 20 % nga Komuna.

Nga komuna e jonë kanë aplikuar një numër i fermerëve për grande në MBPZHR –AZHB.

Përfitues janë disa fermer për Serra, Rritjen- trashjen e Bojlerëve, Ujiqe dhe Turizëm rural.

Përpos punëve ditore më palë ne vazhdimisht kemi vizituar fermerët Blegtor, Bletar, Pemëtar, Lavërtar të cilët i kemi ndihmuar në dhënien e këshillimeve në këto fusha njëkohësisht edhe janë shpërndara edhe broshura me tema të caktuara në lëmin e bujqësisë.

Po ashtu ne mënyrë tabelore po e paraqesim planifikimin dhe realizimin e mbjelljeve vjeshtore 2015/2016

Nr.	Kultura	Sipërfaqet planifikuara/ha	Sipërfaqet realizuara/ha
1	Grurë		4660
2	Elb		55
3	Thekër		150
4	Foragjere		275
	Gjithsej		5140
			5120

Gjatë këtij viti janë mbajtur këshillime bujqësore nga drejtoria e jonë në bashkëpunim me MBPZHR në lëmi të ndryshme të bujqësisë në të cilat kanë marrë pjesë mbi 300 fermer.

Këto trajnime kanë pas për qëllim aftësimin dhe ngritjen e kapaciteteve të fermerëve për lëmit me të cilat merren. Projektet në fjalë kanë ndikuar dukshëm në zhvillimin e bujqësisë, rritjen e të ardhurave për ekonomi familjare dhe ne zbutjen e qeshjes sociale.

Nga pylltaria në gjykatën për Kundërvajtje janë dërguar 72 fletëparaqitje ndaj personave për prejje ilegale në bazë të dhënave që kemi janë shqyrtuar 50 % nga gjykata.

Në prokurorin Publike janë dërguar 2 kallëzime penale.

Po ashtu gjatë këtij viti janë pastruar 10 ha të pyjeve në Volljakë.

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENTE

Në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjente funksionojnë këto sektorë: Sektori i Shërbimeve publike dhe shërbimi i zjarfikësve. Gjatë periudhës vjetore 2016 në sektorin e shërbimeve publike nga ana e palëve janë parashtruar gjithsej: 152 kërkesa, të cilat kanë të bëjnë për ujësjellës, kanalizim, pastrimin e rrugëve nga bora, leje për shfrytëzim të hapësirës publike, pëlqime në ndërtim të objekteve banesore për ndriçim të qytetit dhe

kërkesa për ndihmë me materialit ndërtimor për renovim të shtëpive ,varësisht nga mundësit buxhetore jemi përgjigjur kërkesave të qytetasve. Nga ana e drejtorisë janë shqyrtuar këto kërkesa dhe gjendja është si në vijim:

➤ Të miratuara	78
➤ Të refuzuara	3
➤ Në proces	71

Sektori i shërbimeve publike

Nga kjo drejtori për vitin 2016 janë kryer shumë punë si: mirëmbajtja e rrugëve dimërore dhe verore, ndriçimi eficient i qytetit me drita të standardit me të lart (LED) dhe mirëmbajtja e tyre, dhënia e ndihmave me material ndërtimor për familjet në kushte ekonomike të dobëta dhe kryesisht raste sociale. Pas kërkesave të bëra nga qytetarët është formuar komisioni për verifikimin e rasteve,ku mbikëqyrja ka qenë permanente nga zyrtaret e Komunës dhe ky komision ka bërë shpërndarjen e ndihmave me material ndërtimor sipas vlerësimit të komisionit . Gjatë kësaj periudhe vjetore janë përgatitur dokumentacione për shpalljen e tenderëve që kanë të bëjë me këtë drejtori ku janë realizuar me sukses të gjitha projektet e lartcekura. Si drejtori kemi qenë të kyçur në eliminimin e qenve endacak . Drejtorja e shërbimeve publike dhe emergjente me projekte bindëse ka hyrë në garë për përfitim të donacioneve nga GIZI për menaxhimin e mbeturinave ku kemi plotësuar të gjitha kriteret e caktuara nga GIZI, dhe pasi i kemi plotësuar të gjitha këto kriteret Komuna e Klinës do të jetë përfutuese e një grandit të madh mjetesh të cilat mjete do të shfrytëzohen për mirëqenjen e të gjithë qytetarëve të komunës së Klinës. Gjatë vitit 2016 kemi bërë rehabilitimin e shtratit të lumit ‘’Drini i Bardh’’ nga ura e Haxhis deri të fshatit Zajm me qëllim për të bërë parandalimin e daljes së ujit nga shtrati në rast të ndonjë fatkeqësie natyrore nga të reshurat e shiut, gjithashtu edhe bërë edhe rehabilitimi i shtratit të Lumit në Ranoc dhe Leskoc. Gjatë këtij viti kemi bërë edhe shtruarjen e disa rrugëve me zhavorr,nga kjo drejtori është bërë edhe mirëmbajtja e hapësirave publike në qytetin e Klinës dhe mirëmbajtja e shëtitores përgjatë lumit Klina. Po ashtu zyrtaret e sektorit për shërbime publike kemi qenë të kyçur në komisione për hapje të tenderëve të ndryshëm dhe po ashtu në vlerësimin e tenderëve tjerë.

Përveç punëve të kryera sipas planit vjetor të punës janë dhjetor, janë kryer edhe këto punë dhe aktivitetet:

- Pastrimi i qytetit në bashkëpunim me qendrat rinore, fillimi i aksionit për pastrimin e ambientit nga mbeturinat e lehta në muajin prill.
- Lëshimi i vërtetimeve për rastet e djegies të pronave nga zjarr.
- Lëshimi i procesverbaleve policisë për vendshiqim të zjarreve
- Plani për menaxhimin e mbeturinave
- Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave
- Plani i integritetit
- Pëlqime të përkohshme për shfrytëzimin e hapësirave publike për objektet afariste
- Pëlqime të përkohshme për shfrytëzimin e hapësirave publike me reklama

Duke pasur parasysh ditët e nxeha të verës të cilat fillojnë nga muaj maj, shtohet edhe rreziku i shpërthimit të zjarreve në fusha, shkurre dhe male e sidomos gjatë korrje-fshurjeve si gruri, elbi, tërshëra etj, që rrezikohen nga zjari. Andaj si drejtori kemi marr disa masa për parandalimin e rrezikut të zjarrit. Albës me qellim të vetëdijimit të qytetarëve që mos të bëjnë ndezjen e zjarreve të pa nevojshme dhe rezultati i informimit ka bërë se korrje-fshirjet janë kryer me shumë sukses pa pasur nevojë për ndonjë intervenim. Situata gjatë terë vitit 2016 mund të vlerësohet e shumë e mirë. Kemi bërë edhe 8 raporte mbi vendshiqime të zjarreve, 3 vendshiqime të zjarreve kanë të bëjnë me djegie të shtëpive të banimit 4 raste në shtalla të mbushura me ushqim të bagëtive dhe 1 shkaktar in e zjarrit.

Nga zyra e alarmimit është bërë grumbullimi dhe distribuimi i të gjitha të dhënave në Komunën e Klinës dhe të gjitha këto të dhëna janë raportua edhe ne zyrën regionale ne Pejë. Edhe gjatë këtij viti i kemi vazhduar frekuencat gjithashtu është bërë kontrollimi dhe mirëmbajtja e repetitorit në Tigrvesh, është bërë edhe kontrollimi i alarmit te qytetit i cili gjendet i vendosur mbi postë që të jetë në gjendje gatishmërie ne rast nevojë

Sektori Operativ

NJPZSH në Klinë gjatë kësaj periudhe kohore aktivitetin e vetë e ka bazuar në planin e punës për vitin 2016 dhe si zakonisht ka arritur t'i përmbush me sukses objektivat e parapara me plan. NJPZSH ka vazhduar ta mbaj nivelin e gatishmërisë për reagime në rast nevojë edhe në raste emergjente në periudhën e lartcekur.

Ne jemi angazhuar që shërbimet tona të jenë në nivel të detyrës dhe në përputhshmëri me kapacitetet tona ekzistuese, jemi përgjigjur me kohë kërkesave të qytetarëve të dëmtuar për pajisjen me vërtetime për zjarret e ndodhura.

Edhe për vitin 2016 kemi bër mirëmbajtje dhe riparimin e automjeteve për fikjen e zjarrit me qellim se te jemi ne gjendje sa me te mire ne rast nevojë. Zjarrfikësit vazhdojnë trajnime profesionale te ndryshme te organizuara nga QTE ne Vushtri por me reduktime te theksuara për shkak të numrit te vogël te zjarrfikeseve.

Nga NJPZSH gjatë kësaj periudhe ka pasur gjithsej 215 dalje, 165 raste zjari 24 shërbime dhe 26 intervenime teknike në komunën tone. Në NJPZSH në Klinë disiplina në punë dhe respektimi i orarit të punës është në nivelin e deshurshem, ndërrimet janë kryer sipas orarit të paraparë dhe niveli i gadishmeris si zakonisht ishte në nivel të lartë për t'ju përgjigjur kërkesave-nevojave të qytetarëve të komunës sonë dhe me gjer sipas nevojës dhe kapaciteteve tona ekzistuese.

Nga NJPZSH gjatë kësaj periudhe ka pasur gjithsej 164 dalje, 129 raste zjari 14 shërbime dhe 21 intervenime teknike në komunën tone. Të dhënat e detajuara për intervenimet e NJPZSH gjatë periudhës janar-qershor janë paraqitur në tabelarin që pason. Realizimi i numrit të përgjithshme të daljeve dhe struktura e zjarreve dhe intervenimeve tjera për JANAR - DHJETOR 2016.

Viti: 2016

Komuna:
Klinë

REALIZIMI I NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË DALJEVE DHE INTERVENIMEVE
PER MUAJN JANAR -DHJETOR 2016

	Nr.përgj. i daljeve	Nr.i zjarreve	Shërbime	Aksidente rrugore	Vërshime	Të rrejtshme.	Të ndryshme	Të lënduar
	164	129	14	21	0	0	0	0

STRUKTURA E ZJARREVE					
Viti - 2016	Objekte ndërtimore	Zjarre në sipërfaqe të hapura	Zjarre në automjete	Elektrikë-pajisje elektrike	Të tjera
		9	127	7	5

DREJTORIA E INSPEKTORIATIT

Me qëllim të sendërtimit të Strategjisë afatgjate në jetësimin e sundimit të Ligjit dhe luftimin e Informalitetit-veprimeve kundërligjore të subjekteve që i 'u nënshtrohen kontrollit inspektues, Organet e Drejtorisë për Punë Inspektuese në periudhën raportuese kanë ndermarrur një sërë aktivitete dhe veprimesh koordinuese në bashkëveprim në disa raste edhe me Policinë e Kosovës në: kontrollin e shfrytëzimit të paligjshëm të zhavorit dhe rërës nga shtretërit e lumenjve, kontrollin e bizneseve, mbikëqyrjes së rrjetit të ujësjellësit ,kanalizimit, PTK-së, KEK-ut dëmtimeve eventuale të rrugëve, trotuareve ,hapësirave publike etj., respektimit të Orarit të punës së bizneseve hotelierë sidomos gjatë punës në orët e vonshme të natës, mbarëvajtjes së tregjeve javore, mbikëqyrjen e transportit publik, mbikëqyrjen e pastrimit të rrugëve gjatë stinës së dimrit, kontrollin e artikujve ushqimor dhe të konsumit ditor nga aspekti i rregullsisë shëndetësore dhe afatshmërisë të përdorimit të tyre, kurse ndërlidhur me këtë nga ana e Drejtorisë janë nxjerr një numër i konsideruar i akteve-urdhëresave ekzekutuese për eliminimin e lëshimeve të konstatuara. Këtu duhet shtuar se organizimi i punëve dhe detyrave të punës nga ana e Eprorit të Organit dhe inspektoreve, pos punëve të ushtruara në orarin e rregullt të punës, është bërë edhe gjatë ditëve të vikendit, festave fetare dhe shtetërore dhe me caktimin e kujdestarive si dhe punës në grupe.

Duke ushtruar kompetencat ligjore në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë nga sfera për Taksat, Tarifat dhe Ngarkesat si dhe në shqiptimin e gjobave për shkeljet e shkaktuara ligjore është inkasuar shuma prej 9.306.00€.

Nga personat fizik dhe ata juridik në nivel të Drejtorisë janë proceduar 378 kërkesa të ndryshme nga të cilat janë shqyrtuar dhe zgjidhur sipas procedurës së paraparë ligjore 15 janë refuzuar si të pa bazuara, si dhe 2 janë pezulluar (si të pakompletuara) në procedurën administrative 2 sosh.

Më qellim të informimit të ndërsjellë në relacionin: Organet e Inspektoratit dhe Drejtoria në raport me Drejtoritë tjera dhe Kryetarin e Komunës si dhe në vijën vertikale në raport me Qeverinë dhe Ministrinë gjegjëse, janë hartuar informata, raporte, memorandumet dhe relacione tjera zyrtare në kërkesë të tyre dhe ato sipas detyrës zyrtare.

Duke perceptuar dhe shqyrtuar aspektet dhe veprimet e sipërsëhuara, pashmangshëm rrjedh konstatimi i paraqitjes edhe të vështirësive dhe pengesave tjera që shfaqen përgjatë ushtrimit të kontrollit inspektues sidomos në numrin jo të mjaftueshëm të inspektorëve krahasuar më numrin e banorëve në komunën tonë.

Në vijim paraqitet në vija të shkurtra puna veç e veç e secilit Organ të Inspektoratit pa pretenduar që të shkoqiten punët dhe aktivitetet e tyre rutinore dhe në detaje që janë të përcaktuara në fushëveprimin dhe kompetencat e tyre ligjore.

Inspektimet nga Lëmia Publike

Në këtë lëmi në periudhën raportuese janë ushtruar 210 mbikëqyrje inspektuese e që ka rezultuar me 90 procesverbale të përpiluara në vend. Në objektiv të kontrollit ka qenë rrjeti i kanalizimit, ujësjellësit, ai elektrik, i telekomunikacionit, hapësirat urbane publike, organizimi i punëve në pastrimin edhe matarimin e mbeturinave, veprimet e koordinuara me inspektorët tjerë në aksione të përbashkëta, dalja në vend dhe shqyrtimi-trajtimi i kërkesave të ndryshme të personave fizik dhe juridik të natyrës përkatëse, në stinë e dimrit organizimi dhe pjesëmarrja në pastrimin dhe lirin e rrugëve nga bora dhe punët tjera me prioritet nga fushëveprimi i tij.

Inspektimet nga Lëmi i Ndërtimit

Në këtë resor duke ushtruar mbikëqyrjen inspektuese në zbatimin e dispozitave ligjore të ndërtimit janë ushtruar 41 kontrole duke përfshirë edhe ato monitoruese inspektuese, janë hartuar 38 procesverbale në vend, shënohen 23 shënime zyrtare të natyrës përkatëse gjatë ushtrimit të aktivitetit mbikëqyrës, duke shtuar këtu edhe organizimin e punës në formë kujdestarie, gjatë ditëve të vikendit dhe ayre të festave të ndryshme. Poashtu është koordinuar edhe bashkëpunuar më inspektorët tjerë në kuadër të Drejtorisë në punët e përbashkëta sidomos në kontrollin e eksploatimit të zhavorrit, punët e tregjeve javore, transportin e kombinuesve etj. Nga ky organ janë shqiptuar gjoba në vlerë prej **650.00 €**.

Inspektimi në Lëmin e Komunikacionit/trafikut/

Ky organ në vitin raportues ka ushtruar 60 mbikëqyrje inspektuese nga lëmi i transportit të udhëtarëve dhe mallrave, mbarëvajtja e shenjave të trafikut në rrugët rajonale dhe ato lokale, vendosja në kërkesat e palëve etj. Në lidhje me këtë janë hartuar 47 procesverbale si dhe janë evidentuar 23 monitorime nga sfera e qarkullimit të mjeteve të transportit të udhëtarëve si brenda lokalitetit të Klinës ashtu edhe jashtë saj përkatësisht të qendrave të lokalitetit në territorin e Komunës së Klinës. Po ashtu është bashkëvepruar me organet tjera inspektuese ne aksione të përbashkëta të planifikuara nga Drejtoria, kurse ne proces është zhvillimi i punimeve për vendosjen e shenjave vertikale dhe horizontale te trafikut në qytetin e Klinës nga kompania e cila ka fituar tenderin përkatës.

Inspektimi nga Lëmi i Bujqësisë dhe Ambientit

Gjatë periudhës raportuese nga lëmi i Inspektionit të bujqësisë dhe ambientit janë ushtruar 280 inspektime në mbikëqyrjen e dispozitave të Ligjit për Tokën Bujqësorë dhe në mbrojtën e eksploatimit të paligjshëm të rërës dhe zhavorrit, për mbikëqyrjen e menaxhimit të mbeturinave, në kontrollin e kualitetit të miellit që përdorin furrat e bukës, mbikëqyrje ndaj gurthyesve dhe barnatoreve bujqësore dhe fidanëve/ të tjera. Nga kjo 2 kërkesa te ushtruara për inicimin e procedurës kundërvajtje si dhe 10 gjoba të shqiptuara në vlerën prej 1100 ,00 € , ne bashkëpunim me Drejtorin e Bujqësisë kemi inspektuar 15 raste për Sëmundjen Gungorë.

Inspektimi në Lëminë Sanitare – Komisioni Inspektues

Në zbatim të dispozitave nga lëmi i mbikëqyrjes sanitare dhe të mbrojtjes shëndetësorë të popullatës nga sëmundjet infektuese, atij për duhanin si dhe aktet tjera të kësaj lëmie, Komisioni Inspektues sanitar ka ushtruar 90 mbikëqyrje inspektuese dhe ka përpiluar 56 procesverbale mbi konstatimin e gjendjes në vend. Është punuar aktivisht në transmetimin dhe jetësimin e fushatës në aplikimit të dispozitave ligjore të Duhanit si në rrjetin e objekteve hotelierë ashtu edhe në shkollat fillore dhe të mesme të Komunës. Pjesëmarrja në Komisionin vlerësues të përcaktimit të kushteve minimale teknike, sanitare-higjenike dhe të tjera të lokaleve dhe bizneseve shënohet në 90 raste. Më nismën e këtij organi dhe në bashkëveprim me Inspektoret Sanitarë të Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinës të Rep. së Kosovës, është kontrolluar aspekti i përgjithshëm, kushtet sanitaro-higjenike të subjekteve të ndryshme afariste, janë marre strishot e të punësuarve dhe nga mjetet e punës.

P.S. Nga data 21.05.2014, Inspektori sanitar është pensionuar kurse punët dhe detyrat me autorizim i ka ushtruar Inspektori i Tregut .

Inspektimi në Lëmin e Tregut

Mbikëqyrja e kushteve të ushtrimit të veprimtarive ekonomike, qarkullimit të mallrave dhe shërbimeve, kualiteti i produkteve industriale dhe ushqimore, cilësia e shërbimeve, verifikimi i regjistrimit /pajisja me Certifikata për Regjistrimin e biznesit/ të të gjitha subjekteve afariste tregtare dhe shërbyese, objekteve dhe subjekteve tjera dhe pajisja me Pëlqime për plotësimin e kritereve minimale teknike te lokalit për ushtrimin e bizneseve te ndryshme ka qenë objektiv i punës dhe aktiviteti të këtij organi e që ka ushtruar 250 kontrolle inspektuese me ç`rast ka udhëhequr 164 procesverbale mbi faktimin gjendjes në vend duke

proceduar me nxjerrjen e 97 aktvendimeve përmbajtësorë për eliminimin e të metave të konstatuara duke i vene afatet dhe duke ushtruar kontrollet kthyesë inspektuese për përmbushjen dhe përbarimin e të njëjtëve, atë për paralajmërim për mbyllje-ndërprije të aktivitetit biznesore , po ashtu mbi te njëjten bazë janë ushtruar edhe 31 monitorime.

Shënohen 59 pjesëmarrje në monitorimin dhe mbarëvajtjen e tregjeve javore si dhe 97 raste pjesëmarrjes në Komisionin vlerësues për kushtet minimale teknike, higjieno-sanitare dhe të tjera të lokalit duke nxjerra kështu 97 aktvendime për dhënie e pëlqimeve gjegjëse ku janë inkasuar në emër të shpezuimeve komisionarë inspektuese për këtë qellim 5200 €. Në mbikëqyrjen e Rregullores për orarin e Punës së subjekteve afariste shënohen 12 mbikëqyrje dhe atë më shumë gjatë orëve të vona të natës po ashtu në bash veprim me PK .Në koordinim me Zyrën për biznese janë mbarshtruar dhe është punuar në zgjidhjen e kërkesave për lejimin e zgjatjes së orarit të punës së subjekteve afariste nga lëmia e hotelerisë e që është në përputhje me Rregulloren përkatëse Komunale shënohet për 10 raste. Janë shqiptuar 2 gjoba ne vlere prej 425 euro, Në bashkëpunim me Inspektoret tjerë është larguar qarkullimi i mallit dhe produkteve ushqimore me afat te skaduar për përdorim , te prishur – pa deklaracion ku është inkasuar shuma prej 60 euro ne emër te taksës konformë Rregullores për Taksa dhe Ngarkesa , kurse vlera e mallit te asgjësuar është 11.964.08 euro , Janë ushtruar 2 kërkesa për hapjen e si dhe janë hartuar 13 informata, raporte, shënime zyrtare, sqarime dhe interpretimeve procedurave në vijën horizontale dhe vertikale.

P.S:/Në pasqyrimin e punëve dhe aktiviteteve punuese për periudhën raportuese nuk është përfshirë puna qoftë vetanake qoftë në bashkëveprim me Inspektoret e Tregut në kuadër të MTI-së sipas Planit të Veprimit të Inspektoratit të Tregut të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë të Republikës së Kosovës, kurse sipas një vije të veçante ka qenë obligimi për raportim periodik dhe vjetor/.

Inspektimi nga Lëmi financiar-/regjistrimit/ të bizneseve

Në këtë lëmi janë ushtruar 210 mbikëqyrje inspektuese kurse lidhur me to janë hartuar 90 procesverbale për konstatimin e gjendjes në ven. Janë shqiptuar 2 Gjoba Mandatorë ne vlere prej 450 euro Poashtu është bashkvepru me inspektorin e Tregut te hyrat nga Komisioni Inspektues për kushtet higjieno-teknike e shumën prej 2296 euro si dhe te hyrat vetanake 55 euro. Është punuar edhe me Inspektoret tjerë në nivel të Drejtorisë në aksionet e koordinuara ne përbashkëta dhe në monitorimin e tregjeve për 61 raste. Është udhëhequr evidenca e lëvizjes së pagesave të ndryshme në emër të taksave, ngarkesave dhe tarifave dhe kontrolli në përlogaritjen dhe orientimin e drejtë të tyre.

PROPOZIMI I MASAVE:

Duke konkloduar mbi konstatimet e sipërshënuara dhe efektet e arritura nga periudha raportuese, paraqitet domosdoshmëria në ndërmarrjen e masave dhe veprimeve në:

- *Emërimin e Inspektorit Sanitar sipas procedurave të parapara ligjore dhe atë sa më parë që është e mundur;
- *ngritjen përkatesisht stimulimin material të inspektorëve duke korigjuar koeficientin në përfitimim e të ardhurave personale dhe kompensimin për punën gjatë ditëve të festave, vikendeve apo jashtë orarit të punës;

Gjetja e një zgjidhje për magazinimin-deponimin e mallit përkohësisht të konfiskuar pasi që hapësirat e tilla mungojnë me sigurinë e standardizuar.

*inicionin në Zyrën Ligjore të Komunës për nisjen e procedurave përkatëse të ndryshimit dhe plotësimit të Rregulloreve Komunale që kanë të bëjnë me sfera të

konform me rrethanat aktuale dhe

*shtimin e numrit të Inspektorëve sipas standardeve ligjore në përpjesëtim me numrin e rezidentëve/banorëve/në Komunë.

DREJTORIA PËR KADASTER, GJEODEZI DHE PRONËSI

Drejtoria për Kadaster Gjeodezi dhe Pronësi në Klinë për periudhën Janar - Dhjetor 2016 ka kryer një sërë punësh dhe detyrash të ndryshme nga lëmia e vet duke proceduar kërkesa për ndarje të pronave , regjistrim të hipotekave , parcellime , ekspertiza gjeodezike etj.

Në vijim do të paraqiten në formë tabelare lëndët të cilat i ka kryer Drejtoria për Kadaster Gjeodezi dhe Pronësi për muajt Janar- Dhjetor 2016

LËNDËT	Të pranuar	Në procedurë	Të kryera
Parcellime	250	12	238
Expertiza	21	2	19

Konstatime	12	/	12
Tregim kufiri	5	/	5
Bashkim parcellash	4	/	4
Ndërrim kulture	1	/	1
Regjistrim objekteve	3	/	3
Dhënie produkteve	9	/	9
Historiate	6	1	5
Rexh.i sistem	/	/	/
Shërbimi pron- juridik	8	4	4
Çertifikata	3022	/	3022
Kopje plani	680	/	680
Kërkesa RDPP	782	9	773
GJITHËSEJTË	4803	28	4775

Gjatë periudhës raportuese janë kryer edhe një sërë punësh të cilat nuk mund të maten dhe të raportohen e që janë në interes të qytetarëve , si kërkesat e përditshme dhe të shumta të palëve për shikim të operatorit kadastral , elaboratit dhe planeve me qëllim të marrjes së informacioneve të caktuara mbi gjendjen e pronës , saktësisë së evidencës mbi ndryshimet që paraqiten etj.

Në programin Kadastral-Map janë trajnuar katër punëtor.

Drejtorja për Kadastër Gjeodezi dhe Pronësi në Klinikë mbetet e angazhuar që edhe në muajt në vazhdim të procedoj dhe të kryej me përkushtim dhe profesionalizëm të gjitha kërkesat që paraqiten nga qytetarët që kanë të bëjnë me veprimtarinë e kësaj Drejtorie.

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Spektori i Kulturës

- Regjistrimi i anëtarëve të rinj si dhe aktor të teatrit “Osman.R.Gashi”
- Shënimi i “Ditës se Pavarësisë” 17 shkurt 2016
- Program kulturor- artistike për shënimin e 7 marsit (Ditës se Mesësit)
- Teatri amator Osman.R. Gashi merr pjesë në manifestimin tradicional “Lulëkuqet e Prillit “ Kamenic
- Ekspozita personale “ E nesërmyja” piktor Shahadin Mejzini
- Promovim libri me autor Prend Buzhala “Rrugtime me të bukuren”
- Promovim libri me autore Vlora Zhutaj-Gashi “Hatixhja”
- Shënimi i ditës se teatrit “Osman.R.Gashi”
- Shënimi i festes se Abetare .program kulturore në bashkëpunim me DA dhe shkollat filllore
- Organizimi i ngjarjes kulturore “ Talentet e Vegjël”
- Akademia përkujtimore për dëshmorin Jetullah Desku
- Shënimi i ditës se fëmijëve (program artistik nga fëmijët)
- Tribun shkencore për festivalin “I këndojmë Lirisë”
- Përgatitjet dhe mbajtja e festivalit folklorik “I këndojmë Lirisë”
- Shënimi i ditës se “Çlirimet të Klinikës” (Foto ekspozita me dëshmoret e Klinikës, Programi artistik (koncert) me këngëtar nga trevat shqiptare.
- Aktiviteti kulturorë tek Ujëvara e Mirushes, promovim librash në bashkëpunim me Klubet letrare.
- Shënimi i ditës se Diasporës moton “Ti je pjesë e atdheut” (organizimi i panairit vendor, ekspozitë me piktor klinas ,promovim libri i autorit nga diaspora Luz Thaqi

- Organizim i vendosjes se shiatares se heroit Ndue Perlleshi (akademi perkujtimore, program artistik)
- Pergatitje per pjesemarrje ne festivalin e teatrit ne Ulqin , teatri Osman.R.Gashi
- Organizim dhe mbajtja e Manifestimit tradicional letrarë “ Ora e Tahir Deskut”
- Organizimi i manifestimit “Nderi i qytetit “
- Shfaqja e komedisë “Keqkuptimi “
- Ore letrare ne bashke organizim me klubin e shkrimtareve
- Shënimi i 28 Nëntorit (Program artistik në qendrën e kulturës “Jehona e Dukagjinit”)
- Manifestimi tradicional i dyti me radhë “Art Klina”
- Konferenca përmbyllëse ne kuadër te fushatës 16 ditore “Kundër dhunës në familje”
- Organizimi dhe mbajtja e manifestimit tradicional për fund vit (U ndan mirënjohje për të gjithë ata qe kontribuuan gjatë vitit ne kulture dhe në teatër .

Biblioteka e qytetit “Kongresi i Manastirit”

- Këtë vit numri i lexuesve ka arritur në 594 lexues, nga këta lexues janë lexuar gjithsej 2650 libra. Pasurimi i bibliotekës me fondin librar është bërë me sjell vet librat ne Biblioteke.
- Fondi i librave te dhuruara për vitin 2016 është 370 ekzemplar është bere përpunimi i librit fillimisht, janë regjistruar vulosur plotësuar kartoni i librit dhe janë vendosur për lexim ne salle.
- Biblioteka ne fondin e saj ka gjithsej një fond prej 25394 libra.
- Po ashtu ka vazhduar bashkëpunimi dhe këshilla për lexues që të jen me të kujdesshëm për kthimin e librave , është bere evidentimi i dëmtimit dhe moskthimit të librave nga ana e lexuesve, prandaj është kërkuar vazhdimisht nga lexuesit qe ti kthejnë librat ne bibliotekë,
- Ketë vite është bërë furnizimi i Bibliotekës me material shpenzues për zyre dhe po ashtu edhe me skedar të bibliotekës të cilët nuk i ka pasur disponim biblioteka deri me tani.
- Pasi është krijuar një hapësirë për lexues me 16 ulëse në vitin 2016 kane filluar lexuesit qe ta shfrytëzojnë këtë hapësirë me lexim. Bashkëpunimi me bibliotekën kombëtare dhe rajonale është i mirë dhe do vazhdoje si i tillë.

Zyra e trashëgimisë

- Udhëheqësi i zyrës për Trashëgimi Kulturere në Komunën e Klinës, në vazhden a aktiviteteve të tij ka realizuar synimet në interes të mbrojtjes së vlerave të trashëgimisë kulturore në Komunën e Klinës.
- Gjatë vitit 2016 ne bashkëpunim me Institutin Arkeologjik të Kosovës janë realizuar gërmime ne fshatin Dresnik për 4 muaj rresht ku janë bërë zbulime të themeleve të objekteve të ndryshme te cilat zbulime janë pasqyruar edhe nëpërmjet medieve duke përfshire televizionet, radiot si dhe mjetet tjera elektronike të informimit publik. Ky lokalitet gjatë kësaj periudhe është vizituar nga udhëheqës te lartë shtetëror si ministri i kulturës, arkeolog të rangut të lartë nga Shqipëria dhe me gjerë. Ne të cilim projekt Komuna për vitin 2016 nuk ka participuar fare.

- Gjate vitit 2016 të punës së Zyrës për Trashëgimi Kulturore vlen të cekën vizitat në objektet e paluajtshme të trashëgimisë kulturore, duke shikuar gjendjen e tyre ku shumë prej këtyre objekteve janë në rrenim e sipër, siç janë: kullat dhe monumentet e tjera.

- Si monument i rëndësishëm të veçantë është edhe Ujëvara e Mirushes, rëndësia dhe bukuritë e së cilës gjatë kësaj periudhe janë pasqyruar në televizione të ndryshme nga ana e Zyrtarit për trashëgimi kulturore. Po ashtu janë vizituar kulla të vjetra në terë territorin e Komunës së Klinës të cilat pasqyrojnë lashtësinë e popullit shqiptar. Gjate kësaj periudhe janë mbajtur edhe shume seminare lidhur me çështjen e turizmit në Komunën e Klinës.

Arkivi historik i Klinës

Në Arkivin Historik të Klinës është bërë një punë e vazhdueshme në grumbullimin dhe sistemimin e lëndës arkivore brenda territorit të komunës së Klinës. Arkivi Historik i Klinës posedon 29 fonde, me gjithsej 115 metra gjatësi lëndë arkivore. Në vazhdim të punëve për rregullimin e lëndës arkivore është komunës së Klinës. Sistemimin e materialit të disa fondeve. Nga këto fonde është rregulluar dhe sistemuar lënda nëpër kuti, gjithsej 18 kuti, gjithsej 7978 faqe dokumente, në sasi prej 3.5 metrash. Këtë vit është marrë lënda arkivore e fondkrijuesit Agjencioni Evropian për Rindërtim të shtëpive të dëmtuara nga lufta, gjithsej 5m lëndë. Prioritet për arkivin si edhe viteve tjera ka qenë puna me palë, pranimiti i kërkesave dhe shqyrtimi i tyre. Gjate vitit 2016 janë pranuar dhe shqyrtuar 146 kërkesa për dokumentacion të ndryshëm që posedon arkivi, çoftë për çështje hulumtimi dhe rregullim dokumentacioni. Nga ky numër i kërkesave 32 nuk janë realizuar për shkak të mungesës së lëndës në arkiv. Janë lëshuar gjithsej 221 kopje të vërtetuara të lëndës arkivore të formatit A-4 (64 kopje) dhe A-3 (157 kopje), si dhe janë lëshuar 12 dokumente nga institucioni i arkivit, kryesisht: dëshmi, vërtetime dhe njoftime. Nga hulumtuesit janë hulumtuar Fondet: Kultura Materiale e Klinës me Rrethinë; Gjinnazi „Luigj Gurakuqi”; Shkolla Fillore „Motrat Qiriazi” Klinë dhe Urbanizimi. Është punuar në regjistrimin e lëndës së Fondit Gjinnazi „Luigj Gurakuqi”, vitet shkollore 1980/81 deri në vitin 1990/91. Gjate viti 2016 janë bërë disa vizita pune në Agjencionin Shtetëror të Arkivave të Kosovës, ku me drejtimes të këtij institucioni është diskutuar për legjislacionin arkivor si dhe aspekte tjera me qëllim përfitim e përvojave dhe standardeve të reja të punës.

Zyra e Rinisë

- Në bashkëpunim me kuvendin e të rinjve të Klinës organizuam ligjërata me temën “Ndrysho mendimin, behu i suksesshëm “ me z.Daut Demakun
- Dita ndërkombëtare e Mbrojtjes së Mjedisit (iniciativa për pastrimin e qytetit) në bashkëpunim me qendrën rinore “ Ardhmëria “
- Organizimi dhe përgatitja me të rinjtë për transmetimin e kampionatit evropian para objektit të komunë
- Në bashkëpunim me sektorin sportit organizuam turnirë për të rinjtë e Klinës me rastin e festave tradicionale gjatë vitit kalendarik 2016 si dhe javës së rinisë në disa disiplina sportive.
- Në bashkëpunim me kuvendin e të rinjve klinas në fillim e vitit të ri shkollorë organizuam shpërndarjen në disa shkolla të materialit shkollorë për nxënësit në nevojë
- Organizimi “Ditët e rinisë në Klinë”
- Koloni e vogël me të rinjtë e Klinës
- Vizite me të rinjtë e Klinës mono metëve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore
- Maratonë në ciklizëm 16 km
- Në bashkëpunim me shoqatën e peshkatarëve organizuam një ligjërata dhe peshkim një ditor tek Lumi “Drini i Bardh”

- Aktivitete rinore ne bashkëpunim me Qendrën Rinore 'Ardhmëria' Halloëen n'Klinë
- Riaktivizimi i KVRL organizimi i kuvendit të ri zgjedhor
- Shënimi i ditës ndërkombëtare kundër HIV-it , bashke organizim me qendrën rinore.
- Koncert humanitar të organizuar nga grupi rinor "Klina Youth Chahter" për mbledhje të fondeve për familjet e varfëria i mbështetur nga DKRS
- Mbëmje rinore me talentet e Klinës me rastin e fesave të fund vitit

Zyra e Sportit

- Themelimi i klubit të hendbollit të meshkujve KHM"Dukagjini"
- Faza përgatitore për kampionatin pranveror të Kosovës ne futboll (KF "Dukagjini") (M), (F)
- Faza përgatitore për kampionatin pranveror të Kosovës në volejboll
- Aktivitete sportive për nder të shpalljes se Pavarësisë së Kosovës
- Organizimi i turnirëve për nder të FF "I këndojmë Lirisë" dhe "Ditës se Çlirimit të Klinës"
- (Futboll, basketboll, shah, volejboll dhe ping-pong)
- Përirimi i palestrës sportive "Adem Jashari"
- Faza përgatitore për kampionatin vjeshtor të Kosovës ne dy disiplina në futboll (KF "Dukagjini), KFF "Dukagjini", volejboll KV "Dukagjini" dhe hendboll KHD 'Dukagjini"
- Fillimi i kampionatit vjeshtor në futboll, volejboll dhe Shah
- Organizimi i turnirëve në disa disiplina me rastin e festës se 28 Nëntorit – Ditës se Flamurit
- Organizimi dhe mbajtja e manifestimit tradicional për përzgjedhjen e sportistit të Vitit

ZYRA LIGJORE DHE PËRFAQËSIMI I KOMUNËS SË KLINËS PËR PERIUDHËN KOHORE JANAR-DHJETOR TË VITIT 2016

Në kuadër të aktivitetit të Zyrës se Përfaqësimit dhe asaj ligjore përfshihet përgjegjësia kryesore e Përfaqësimit të Komunës në të gjitha shkallët gjyqësore si dhe në të gjitha organet të tjera të administratës shtetërore në nivel vendi. Zyra ligjore ishte edhe pjesë e të gjitha debateve dhe takimeve tjera me publikum qe ishin mbajtur gjatë periudhës raportuese. Zyra po ashtu ishte pjesë e të gjitha seancave të Komiteteve komunale, e posaçërisht të Kuvendit të Komunës. Sa i përket numrit të lëndëve të reja të aktualizuara në vitin 2016 ai numër është përafërsisht i njëjtte ngase 1 (një) lëndë më tepër të re e kemi në vitin 2016. Më poshtë bëhet paraqitja e lëndëve të reja gjyqësore të aktualizuara gjatë terë vitit 2016 në krahasim më të njëjtën periudhë të terë vitit 2015.

Tabelari dhe Komparacioni i lëndëve gjyqësore të aktualizuara-paraqitura gjatë vitit 2016, në raport më të njëjtën periudhë të vitit 2015

I.	II.
Gjithsej numri i lëndëve në tërë vitin 2016 (Janar-dhjetor) 18	Vërejtje
e sipër të gjykatat kompetente.	Të gjitha lëndet e tilla janë në procedurë e
Gjithsej numri i lëndëve në vitin 2015 (Janar-dhjetor)	Vërejtje
17 sipër të gjykatat kompetente.	Të gjitha lëndët e tilla janë në procedurë e

Siç shihet nga krahasimet e periudhave raportuese, në vitin 2016 ishin aktualizuar gjithsejtë 18 lëndë të reja gjyqësore përderisa që ai numër i lëndëve në vitin 2015 ishte gjithsejtë 17 lëndë. Krijt ato lëndë kishin pasur kërkesëpadi e natyrave të ndryshme juridike sidomos Kërkesëpadi civile-kontestimore si: Vërtetim pronësie, pastaj nga lemia e Marrëdhënies së punës, e Drejta e shfrytëzimit të tokës komunale-trojet ndërtimore, Borxhet përkatëse financiare të komunës ndaj subjekteve të tjera dhe e kundërta si dhe lëndë të tjera. Sa i përket shqyrtimeve gjyqësore dhe seancave gjyqësore të mbajtura të gjykatat e vendit gjatë tërë vitit 2016 janë mbajtur gjithsejtë 169 seanca të shqyrtimeve gjyqësore duke përfshi ato përgatitore dhe ato të rregullta e që në krahasim më vitin paraprak 2015 që ishin mbajtur 179 seanca gjyqësore del diferenca që në vitin 2016 ishin mbajtur më pakë 17 seanca.

Tabelari dhe Komparacioni i seancave gjyqësore të mbajtura gjatë tërë vitit 2016, në raport më të njëjtën periudhë të vitit 2015

I.	II.
Gjithsej numri i seancave në vitin 2016 (Janar-dhjetor) 162	Vërejtje

Më pastaj Zyra ligjore dhe Përfaqësimit ka përfaqësuar komunën edhe në të gjitha nivelet ministore sa i përket përfaqësimit të lëndëve konkrete administrative, ku ka lind nevoja, po edhe të këshillimeve përkatëse për të gjitha çështjet juridike. Në këtë drejtim zyra ka marr pjesë në të gjitha takimet zyrtare unifikimit të veprimeve dhe të gjitha procedurave ligjore në nivel vendi. Zyra ligjore dhe e Përfaqësimit ishte përfaqësuese edhe në nivele të tjera të organeve dhe asociacionet tjera të Shtetit të Kosovës siç është Agjencioni Kosovar i Privatizimit, pastaj Agjencioni Kosovar të Pronës (ish HABITAT-it), Zyrës Rajonale në Pejë kur është paraqitur nevoja e pranimi të vendimeve grupore të KPA-së se më Zyrën komunale për Marrëdhënie Pronësore-juridike. Po ashtu zyra ka pas raporte të ndërsjella edhe bashkëpunim, si për çdo vit edhe këtë vit me Zyrën e OSBE-së në nivelin komunal dhe Rajonal në Pejë. Zyra ka bashkëpunuar dhe ka ndihmuar edhe Shërbimin për Punë të Kuvendit në përgatitjen e terë materialeve dhe vendimeve në aspektin e sigurimit të bazës juridike dhe ligjore, po edhe në ndihmën e hartimit të tyre sipas nevoje, duke përfshi këtu pjesëmarrjen në seanca të Kuvendit të Komunës si dhe pjesëmarrjen në mbledhjet e Komiteteve të obligueshme komunale si trupa ndihmëse të Kuvendit të Komunës. Zyra si çdo vit po ashtu edhe gjatë vitit 2016 ishte pjesë e të gjitha seancave të Komiteteve komunale, e posaçërisht Komitetit për Politik dhe Financa dhe seanca e Kuvendit të Komunës, në të cilat është dhenë kontributi, sqarues, këshillues ligjor dhe mendimi përkatës profesional. Zyra Ligjore po ashtu në kuadër të kompetencave të veta gjatë terë viti 2016 ka lëshuar edhe akte të tjera juridike, si për Zyrën e Kryetarit të Komunës po ashtu edhe për terë Ekzekutivin komunal, si: vendime, Urdhëresa, Pëlqime, Aktvendime, ka hartuar Marrëveshje të ndryshme, Autorizime, Konkluzione e shkresa dhe akte të tjera të cilat radhitën si në vijim: 107 vendime, 4 propozime, 13 njoftime, 28 kërkesa, 25 autorizime, 6 Urdhëresa, 8 pëlqime, 2 marrëveshje, 10 përgjigje, 10 shkresa përcjellëse; 3 ankesa, 7 mendime juridike, 5 raporte si dhe 5 procesverbale si dhe akte tjera komunikuese. Pë të gjitha kërkesat dhe aktet tjera zyrtare të cilat janë futur në shërbimin e intranetit të Zyra e Kryetarit si te Zyra Ligjore dhe Përfaqësimit i është ndërruar statusi i lëndëve ashtu sipas vendosjes se tyre nga organet kompetente. Po ashtu ZL ka raportuar në MAPL në Divizionin e Përfomancës për vitin 2016 lidhur më 14 shërbimet komunale sipas formularëve përkatës të MAPL-ës. Në kuadër të aktiviteteve tjera ligjore zyra po ashtu ka ofruar të gjitha këshillat e nevojshme dhe të kërkua nga strukturat tjera të administratës komunale. Zyra edhe gjatë vitit raportues ka qenë në rrjedha të përcjelljes se ndryshimeve përkatëse ligjore të të gjitha ligjeve qe prekin kompetencat e pushtetit lokal, krejt kjo më qellim edhe të nxjerrjes se rregulloreve përkatëse komunale siç ishte Rregullorja për Ndarjen e Bursave, Rregullore për Disiplinën e Nxënësve Neper Shkolla, Rregulloren për Mbrojtjen e te Miturve nga dukurit qe dëmtojnë Shëndetin dhe Zhvillimin e tyre si dhe Rregulloren për shfrytëzimin e Palestrës Sportive.

Po ashtu zyra si çdo vit ka pasur një bashkëpunim dhe koordinim të aktiviteteve ligjore dhe komentimeve të projekt ligjeve përkatëse të cilat i janë dërguar Asociacionit të Komunave të Kosovës, përmes të cilit vlen të theksohet dhe çmohet organizimi i takimeve të zyrtarëve ligjor të komunave të Kosovës ku ka marr pjesë edhe zyra e jonë, duke marr pjesë edhe në trajnimet përkatëse të organizuara nga AKK-ës dhe në përkrrahje të OSBE-së.

ZYRA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

Hyrje

Zyra për Komunitete dhe Kthim punon bazuar në statutin e Komunës së Klinës si dhe Rregullores qeveritare 2/2010 e cila parasheh edhe numrin e të punësuarve. Gjatë vitit 2016, ZKK punën e vet a bazon edhe në ligjet përkatëse që rregullojnë fushë-veprimtarinë e saj. Gjatë viti 2016 ZKK vazhdoj bashkëpunimin e saj si me institucionet përkatëse qeveritare si me ato joqeveritare. Posaçërisht duhet përmendur bashkëpunimin me Ministrinë për Kthim dhe Komunitete, organet komunale si dhe me zyrën për kthim që funksionon në kuadër të zyrës së Kryeministrit të Kosovës. Numri I të punësuarve në ZKK është 5 (pesë) dhe ka në dispozicion 2 (dy) vetura me të cilat kryen detyrat e saj në terren.

Vështrim i përgjithshëm mbi të drejtat e komuniteteve dhe qasja në shërbime

Të drejtat e bashkësive, në shumicën e rasteve, janë të respektuara sipas situatës së dhënë. Për fat të keq, ende janë disa raste, në numër të vogël, ku ka mosrespektim të këtyre të drejtave, kryesisht në të drejtën për pronë dhe uzurpim të tyre, prejre ilegale të pyjeve, shfrytëzim ilegal të tokës bujqësore. Në ndihëm e ZKK, të gjitha këto raste janë dërguar në gjykatën përkatëse. Në përgjithësi, të drejtat e komuniteteve në komunën e Klinës nuk janë shumë të prekura falënderuar përkrrahjes dhe angazhimit të faktorëve relevant të nivelit lokal.

Të gjitha komunitetet në komunën e Klinës kanë shërbimet publike dhe ato komunale pa asnjë dallim.

Funksionimi i strukturave tjera që kanë të bëjnë me komunitete

Si pjesë e Kuvendit Komunal, funksionon edhe Komiteti për Komunitet i përbërë nga 7 anëtar (3 nga Kuvendi dhe 4 nga komunitet përkatëse). Ky komitet funksionon rregullisht duke mbajtur takimet e veta të rregullta mujore ku diskutohen tema me interes për secilin komunitet në Klinë.

KKSB (Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi) mban takimet e veta të rregullta në çdo dy muaj. Ky këshill vlerëson se gjendja e sigurisë si dhe lëvizja e lirë janë në nivel të kënaqshëm dhe me tendenca të përmirësimit të mëtejshëm. Në komunën e Klinës janë themeluar dy këshille lokale për siguri dhe të cilët kryejnë funksionin e tyre brenda mundësive dhe autorizimeve përkatëse.

Kthimi

Falë punës dhe angazhimit të koordinuar të të gjithë aktorëve në periudhën për të cilën raportojmë, janë arritur rezultate të dukshme në procesin e kthimit, si individual si grupor. Përmes ZKK, janë përpunuar me dhjetëra kërkesa për kthim të personave të zhvendosur, kërkesa dërguar Ministrisë për kthim dhe kryer në bashkëpunim me IOM, UNHCR, DRC, Komunën dhe OJQ tjera. Në vitin 2016, është organizuar një (1) vizitë SHKO dhe SHIQO për të zhvendosurit në Mal të Zi, kampin e të zhvendosurve në Konik

Po ashtu, përmes ZKK dhe OJQ tjera, është arritur që të organizohen 3 vizita në fshatin Gremnik nga të zhvendosurit në serbi dhe 2 vizita në fshatin Dranashiq. Komuna dhe personeli i ZKK në të gjitha këto raste ishin në krye të detyrës dhe përgjegjësisë të veta duke ofruar përkrahjen e tyre që këto vizita të jenë në funksion të të zhvendosurve.

Gjatë vizitave të përmendura, ZKK ka ofruar përkrahjen e saj që të zhvendosurit të nxjerrin dokumentet civile përkatëse, përgatitjen e dokumenteve të ndryshëm për kthim, vizitën në pronat e tyre si dhe vizitat tek të kthyerit e mëhershëm. Të kthyerit e mundshëm janë informuar mbi procesin e kthimit si dhe mënyrën e aplikimit për kthim. Si rezultat i këtyre vizitave dhe si rrjedhojë e disa takimeve të NënGrupit Punues për Kthim (TASK-FORCE) dhe i një takimi të Grupit Komunal për Kthim është përpiluar dhe konfirmuar lista prej 10 aplikantëve të për kthim e cila tanimë i është dërguar MKK në Prishtinë. Duke falënderuar angazhimin e organeve komunale dhe vullnetit të tyre për të krijuar një klimë edhe më të mirë për kthim të të gjithë të zhvendosurve si dhe për një të ardhme më të mirë, në vitin 2016 kemi pasur një mori aktivitete për të realizuar kthim të personave të zhvendosur në Mal të Zi. Komuna e Klinës ka ndërmarr edhe një hap tujë duke ndarë troje shtesë për familjet që nuk kanë pronë të veten, familje të komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptas. Nga këto janë ndërtuar 4 shtëpi ndërsa shkaku I përfundimit të sezonit ndërtimor 3 shtëpi tjera kanë mbetur të ndërtohen në vitin 2017.

ZKK në bashkëpunim me IOM ka ndihmuar në krijimin e kushteve për strehim për 3 familje në Dresnik dhe nga një në Dugajevë, Rudicë dhe Klinafc. Në listë janë përpunuar edhe 11 familje tjera 7 për Dranashiq dhe 4 për Klinafc.

ZKK ishte bartëse e përpilimit dhe miratimit të Planit të veprimit për Kthim dhe Zgjidhje të Qëndrueshme për periudhën 2017-2018. Ky plan parasheh që në vitet 2017 dhe 2018 të realizohen 98 kërkesa për kthim nga mbi 200 sa është numri total i kërkesave.

Ri-atdhesimi

Grupi Komunal Punues për ri-atdhesim rregullisht përcjell dhe analizon kërkesat nga të riadhesuarit. Në vitin 2016 ky grup ka shqyrtuar 84 kërkesa të tilla të cilat ishin të përcjelluara edhe me planet e biznesit sipas nevojave të kërkuarve. Në periudhën raportuese janë kthyer apo ri-atdhesuar 33 familje (21 shqiptare, 9 egjiptase dhe 3 rome) me 175 anëtar gjithsej. Janë 7 familje që në dy muajt e parë kanë marrë ndihma në ushqim por që më pastaj kjo ndihmë është ndërprerë nga ana e ministrisë përkatëse. Nga 11 familje që u strehuan, për 2 ka kaluar

afati njëvjeçar i strehimit i siguruar nga ministria. Deri më tani, vetëm 2 familjeve ju është ndërtuar shtëpia, 1 familje pret përgjigje nga ministria ndërsa 3 familje tjera kanë dorëzuar kërkesë për ndihmë në material ndërtimor. ZKK ka përpiluar dhe te një OJQ në Graçanicë ka dorëzuar listën prej 15 familjeve të komunitetit RAE të komunës së Klinës për ndërtim shtëpie.

ZKK në bashkëpunim me UNDP ka arritur që të punësoj përkohësisht 3 persona të komuniteteve pakicë nga lista e të papunësuarve në entin e punësimit. Punëtorët e ZKK ishin aktiv edhe në ofrim të ndihmës për të gjithë nxënësit dhe studentët e komuniteteve minoritare sa I përket nostrifikimi të diplomave dhe rregullimit të kërkesave për bursë.

Përmes ZKK është organizuar edhe shpërndarja e materialit dhe ndihmave të ndryshme sociale për familjet e rrezikuara sociale. Gjatë vitit 2016, ZKK ka dhënë ndihmën e saj dhe është përpjekur të ju ndihmoj secilit që ka pasur nevojë për të rregulluar ndonjë çështje të caktuar në komunë. ZKK ka vazhduar bashkëpunimin e vet me të gjitha institucionet përkatëse si për shembull UNHCR, CRPK, USAID, DRC, IOM, ASB, UNMIK, OSCE, LMT, KFOR Italian, OJQ rinore, OJQ ZANA dhe të tjerë.

Buxhetimi dhe projektet

Gjatë përpilimit dhe miratimit të buxhetit të vitit 2016, ZKK ka propozuar 5 projekte të cilët janë drejtpërdrejtë të lidhur me komunitetet pakicë dhe qëndrueshmëri të kthimit. Poashtu, disa projekte nga Plani i Punës për Këshillin e Sigurisë në Bashkësi dhe që nuk arritën të realizuara në vitin 2015 u përfunduan në vitin 2016.

Në total, gjatë vitit 2016, ZKK arriti të realizoj, me ndihmën e organeve tjera, IOM, MKK, UNDP dhe Komunën 6 projekte për stabilizim të kthimit dhe zhvillim të komuniteteve.

Këto projekte përfshin ndihma në pajisje të ndryshme bujqësore (traktor, moto-kultivatorë dhe të tilla), ndihma këto që mundësuan krijim të të hyrave për familjet përfutuese.

Projektet kapitale ishin ato në thetoren e Videjës me 12 familje si kultivues të mishit të derrit, renovimi i shkollës në Shupel, asfaltimi rrugës në Klinafc dhe kanalizimi poashtu në Klinafc. Këtu duhet cekur edhe ndriçimin publik në gjatësi 3km në Rudicë financuar nga USAID.

Kryetari i Komunës,

